



INSTITUCIONET E PËRKOHËSHME VETËQEVERISËSE  
QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS



## RAPORTI VJETOR 2007



GODIŠNJI IZVEŠTAJ 2007  
ANNUAL REPORT 2007

Prishtinë Janar 2008

**LOGO I KPMK-së**



## PËRMBAJTJA

Logoja e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.....	faqe 2
Përmbajtja .....	faqe 3
Shkurtesat.....	faqe 4
Hyrje .....	faqe 5
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës .....	faqe 6
Përbërja e Këshillit .....	f/ 7-8
Baza ligjore e veprimit .....	faqe 9
Raporti vjetor në shifra .....	faqe 10
Funksioni i ankesave .....	f/11-19
Implementimi i vendimeve.....	f/ 20-45
Funksioni i shqyrtimit të emërimeve të drejtorëve të departamenteve në SHCK.....	f/46-53
Funksioni i respektimit të Ligjit të SHCK.....	f/53-58
Aktivitete të tjera të këshillit dhe bashkëpunimi me organe tjera .....	f /59-67
Raporti me organizata vendore e ndërkombëtare.....	f/ 68-73

## SHKURTESAT

- KPMK- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
- IPVQ- Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
- UNMIK- Misioni i Kombeve të bashkuara në Kosovë
- PSSP- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
- MSHP- Ministria e Shërbimeve Publike
- SHCK- Shërbimi Civil i Kosovës
- K. E - Kryeshefi Ekzekutiv ( i komunës apo agjencisë ekzekutive)
- RREG.- Rregullore për Shërbim Civil të Kosovës
- UA- Urdhëresa Administrative (2003/2)
- LPA – Ligji i Procedurës Administrative
- UA- Udhëzimet Administrative(2005/01 dhe 2005/02)
- QKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës
- UP -- Universiteti i Prishtinës
- AP- Autoriteti punëdhënës
- OSBE- Organizata për Bashkëpunim e Siguri në Europë
- DFID- Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (U.K.)



## H Y R J E

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (KPMK), duke respektuar dispozitën e nenit 14.1 të Rregullores 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, me qëllim të informimit të plotë për aktivitetin e tij gjatë vitit 2007, ka kënaqësinë që organeve kompetente dhe publikut të gjerë t'u paraqesë Raportin për vitin e kaluar.

Veprimtaria e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2007, në tërësinë e saj, është orientuar dhe venë në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të përcaktuara me Planin e punës ,

Të bindur se *“realizimi i objektivave nuk mund të bëhet pa një përkushtim të plotë dhe maksimalisht të sinqertë, të të gjitha potencialeve ekzistuese, pa një qasje profesionale dhe angazhim të përgjithshëm në përmbushjen e misionit që ia ka dhënë ligji. KPMK thjeshtë vetëm nuk ka mbikëqyrë dhe monitoruar, nuk ka dhënë vetëm urdhra, obligime apo imponime, por në masë të madhe ka dhënë këshilla, është konsultuar dhe ka bashkëbiseduar me autoritetet punëdhënëse në Shërbimin Civil të Kosovës dhe krejt me qëllim të arritjes të një niveli më të lartë të zbatimit të dispozitave ligjore dhe përkushtimit për një shërbim civil të qëndrueshëm dhe profesional.*

*Gjatë vitit 2007 KPMK ka synuar të:*

- Japë përgjigje efektive në shqetësimet e shërbyesve civilë,
- Identifikojë fushat në të cilat aplikimi i Ligjit mbi Shërbimin Civil ka ngecje dhe të japë rekomandime për përmirësimin e situatave ku paraqitet nevoja.
  - Zhvillojë kapacitetet e brendshme të KPMK-së me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës
  - Bëjë transformimin e tij në një organ tërësisht të pavarur, që do ti raportojë Kuvendit të Kosovës.

Tërë aktiviteti i KPMK-së që pasqyrohet në këtë raport ka qëllimin e tij të vazhdueshëm që ky organ të jetë garant i një Shërbimi Civil etik, të bazuar në ligj, i shumëllojshëm , efikas dhe mbi të gjitha në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës. Duke pasur parasysh faktin se një shërbim civil i organizuar mirë me një administratë kompetente është parakusht i funksionimit të institucioneve demokratike dhe shenjë e sundimit të së drejtës.

Natyrisht raporti i tretë vjetor të cilin e hartoi Këshilli nuk ka pretendim të pasqyrojë të gjitha ato që janë bërë brenda vitit raportues, sepse qëllimi është të vënë në spikamë pikat kryesore të aktiviteteve të tij, duke përfshirë atë që cilësohet si sukses i këshillit, vështirësitë gjatë punës , mangësitë apo ngecjet gjatë ushtrimit të detyrave dhe sfidat e të ardhmes, e veçanërisht **transformimin** e tij, në një organ që do ti raportojë drejtpërsëdrejti Kuvendit të Kosovës.

Me këtë rast falënderojmë të gjitha organet vendore e ndërkombëtare për mirëkuptimin dhe përkrahjen e vazhdueshme në punën e KPMK-së.

Me respekt:

Sevdail Kastrati, kryetar i këshillit.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKQYRËS I KOSOVËS

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës është organ i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës me të cilën janë paraparë: funksionet, përbërja, kompetencat dhe fushë veprimtaria e këshillit.

Këshilli zyrtarisht është formuar më 23 shtator 2004, me ç`rast anëtarët e KPMK kanë bërë betimin solemn dhe kanë filluar me aktivitetin e tyre në këshill.

KPMK ka shtatë anëtarë të cilët emërohen nga PSSP me pëlqimin e Kryeministrit të Kosovës, duke u zgjedhur sipas konkursit publik, në proceduara të hapura konkurruese dhe duke respektuar parimin e meritës.

Këshilli ka kryetarin e këshillit të zgjedhur nga këshilli.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit Për Shërbimin Civil anëtarët e KPMK-së nuk janë shërbyes civilë.

Këshilli ka sekretariatit e tij, i cili përbëhet nga punëtorët që janë shërbyes civilë në kuptimin e ligjit dhe që për nevojat e KPMK-së kryejnë punë administrativo-teknike e përgatitore dhe janë staf mbështetës i këshillit.

Anëtarët e këshillit zgjidhen për një afat kohor të paraparë me ligj dhe mund të shkarkohen nga detyra vetëm në rastet e parapara me ligj.

Të gjithë anëtarët e tanishëm të Këshillit kanë një përvojë pune në administratën publike, në menaxhimin e resurseve humane dhe përvojë në gjykatat e Kosovës që absolutisht i bënë ata të përshtatshëm dhe kredibil në ushtrimin e funksioneve të anëtarit të Këshillit.

Këshilli sipas ligjit në fuqi ka tri funksione kyçe:

- Funksionin e zgjedhjes së ankesave të shërbyesve civilë dhe konkurruesve për punë në SHCK në shkallë të fundit në procedurën administrative.
- Funksionin e shqyrtimit të emërimeve të udhëheqësve të departamenteve në Shërbimin Civil të Kosovës.
- Funksionin e vlerësimit të respektimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës në Autoritetet Punëdhënëse të SHCK.

## PËRBËRJA E KËSHILLIT



Sevdail Kastrati, kryetar i këshillit, jurist i diplomuar, ka të kryer shkollën për Integritim Evropian, shumë trajnime nga lëmi e shërbimit civil. Që nga viti 1986 punon ekskluzivisht në sferën juridike të marrëdhënieve të punës, flet gjuhën angleze dhe serbokroate.



**Bisera Spahi**, anëtare e KPMK-së, ekonomiste e diplomuar. Ka punuar si Menaxhere e Personelit në MSHP. Është certifikuar për Udhëheqëse e resurseve humane në Shërbimin Civil të Kosovës si dhe për trajner internacional për prokurimin publik. Gjithashtu është certifikuar nga NAAC për udhëheqje (lidersheep) lidhur me zhvillimin ndërkombëtar të institucioneve kosovare për administratën publike. Ka kryer shkollën për udhëheqje (lidersheep) të Agjencisë Nacionale Amerikane për bashkëpunim ndërkombëtar me IAPK. Prej nëntorit të vitit 2004 është emëruar për anëtarin e KPMK-së.



Mursel Ahmeti ka kryer fakultetin juridik më 1982. Provimin profesional për administratë dhe përvojë të suksesshme si jurist. Ka të kryera këto trajnime: Shërbimi Civil të Kosovës, Legjislacioni, Procedurat, dhe Teknikat e Menaxhimit si dhe trajnimin për anëtar të bordit. Ka punuar si udhëheqë i Sektorit Pronësor -Juridik nga viti 1985 deri 1990 dhe Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në komunën e Mitrovicës prej vitit 2001 deri 2004. Në vitin 2004 është emëruar anëtar i Këshillit Pavarur Mbikqyrës i Kosovës.



Nebojsa Azdejković ka kryer fakultetin Juridik dhe Ekonomik në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 2000 kreu studimet postdiplomike, Akademinë Policore në Vushtrri. Ka specializuar në lëmin kundër krimit të Organizuar në SHBA. Prej vitit 2001, ishte anëtar i Bordit për ankesa pranë Komisarariatit të policisë së UNMIK –ut. Më 2004 është emëruar anëtar i KPMK-së. Nga viti 2006 është zgjedhur anëtar i Grupit të ekspertëve për Reformën e Administratës Publike. Flet gjuhët serbe, shqipe dhe angleze.



Bajram Zogiani anëtar i Këshillit, jurist i diplomuar, ka të kryer provimin e judikaturës, trajner i ShCK-së , tërë përvojën e punës në administratë . Ka të kryer shumë trajnime në ShCK , legjislacion dhe gjykata .



Flora Balidemaj-Hoxha, anëtare e Këshillit, magjistër i shkencave juridike, drejtimi penalo-juridik. Ka të kryer provimin e judikaturës dhe shumë trajnime nga lëmi e gjyqësorit dhe tash së fundi nga shërbimi civil. Nga viti 2003 deri më 2007, ka punuar si bashkëpunëtoare profesionale dhe sekretare e Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa nga qershori i vitit 2007 punon në KPMK.  
Flet gjuhën angleze dhe serbokroate.

## BAZA LIGJORE PËR VEPRIM

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës bazën ligjore për ushtrimin e aktiviteteve të veta e ka në legjislacionin pozitiv në Kosovë dhe sidomos në:

- Rregulloren 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës,
- UA 2003/2 për implementimin e Rregullores 2001/36,
- Ligjin Mbi procedurat Administrative (ligji i K. Kosovës nr 02L-28),
- Udhëzimin Administrativ 2005/01 për Rregullat e punës të KPMK,
- Urdhëresa administrativ për rregullat e proceduarve të ankimit në KPMK 2005/2,
- 12 udhëzimet administrative të MSHP për procedurat e SHCK,
- Ligjet e aplikueshme në Kosovë sipas Rregullores, nr. 1999/24 për Ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

KPMK ka marrë për bazë edhe udhëzimet administrative dhe këshillat ligjore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që kanë të bëjnë me çështje konkrete në komunat e Kosovës.

Përpos kësaj, KPMK gjatë vizitave monitoruese ka përdorur edhe pyetësozin për zhvillimin e kontrollimeve monitoruese lidhur me pajtueshmërinë e aplikimit të Ligjit të SHCK në autoritet punëdhënëse, hartues i të cilit është vet këshilli.

Gjithashtu palët ankuese janë të obliguara të plotësojnë formën e obligueshme të ankimit me të gjitha pozicionet e parapara ne te në përputhje me dispozitat e UA 2005/02 për Procedurat e Ankimit që u Përmbahet KPMK-ja.

Një burim tjetër formal dhe praktik të cilin anëtarët e KPMK e shfrytëzojnë sidomos gjatë procedurave të organizimit dhe mbajtjes së seancave dëgjimore me palët e pranishme është Broshura Udhëzuese e cila u hartua nga KPMK dhe OSBE ,ndërsa u diskutua dhe u Aprovua në seminarin organizuar të përbashkët në Ohër të Maqedonisë në vitin 2006 dhe përvoja e marrë nga mënyra e organizimit dhe mbajtjes së seancave dëgjimore në Komisionin dhe Tribunalin e Shërbimit Civil të Kanadasë ku anëtarët e KPMK-së pos tryezave të punës kanë marr pjesë edhe në seanca dëgjimore të këtyre organeve duke parë zhvillimin praktik të tyre.



## 2007 - NË SHIFRA - RAPORTI NË NJË SHIKIM

ANKESAT:

Në vitin 2007 gjithsejtë kanë arritur 384 ankesa.

Nacionaliteti		Gjinia		Organi punëdhënës		Baza ankimore	
Shqiptarë	378	meshkuj	296	Ministria	183	Ndërprerje e kont.së punës	127
Serb	02	femra	82	Agjen.ekzekutive	12	mospërtrirje e kont.së punës	138
Të tjerë	04	Të tjerë	06	komuna	180	Kontestim konkursi	40
				Zyra e kryeministrit	1	Degradim nga posti	11
				Instucioni i Omduspersonit	1	Kompensim material	26
				Të tjera(spitalet regj, ATK ,UP etj.	7	Suspendim nga puna	05
						Bazat tjera	37

### ANKESA TË ZGJIDHURA

Janë zgjidhur gjithsej 386 ankesa 294 të vitit 2007 dhe 92 të viteve paraprahe. Prej tyre sipas njoftimeve që ka marrë KPMK , 39 vendime nuk janë zbatuar.

Të aprovuara	78	
Pjesërisht të aprovuara	33	
Te hedhura poshtë	60	
Te refuzuara	193	
Në forma tjera	22	

### VIZITA MONITORESE NË AUTORITETE PUNËDHËSE-PAJTUSHMËRIA ME LIGJIN MBI SHËRBIM CIVIL

A. punëdhënëse	rekomandime		Realizimi përcillet gjatë 6 mujorit të parë 2008	
Ministri	11	48 pika rekomanduese		
komuna	20	73 pika rekomanduese		
Agjenci ekzek.	4	19 pika rekomand.		
Autoritete tjera	8	Pika rekomaduese 30		

### MONITORIMI I ZGJEDHJES TË DREJTORËVE TË DEPARTAMENTEVE

A. punëdhënëse	rekomandime		realizuar	Nuk janë përfillur
Ministri	52	9	8	1(Min.e kultures)
komuna	79	13	12	1(komu.e Klinës
Agjenci ekzek.				
Autoritete tjera	3	3	3	

### ELABORIMI I DETAJUAR I AKTIVITETVE TË KËSHILLIT

## FUNKSIONI I ZGJIDHJES SË ANKESAVE

Shërbyesit Civil të punësuar në Shërbimin Civil të Kosovës kur konsiderojnë se me ndonjë veprim të Autoritetit të tyre punëdhënës u është shkelë ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës kanë të drejtë ti ankohen Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Kjo e drejtë shërbyesve civilë u takon vetëm në rastin kur ata kanë shfrytëzuar – shtjerrë të gjitha mjetet ankimore brenda institucionit ku ata punojnë apo kanë punuar.

Po të njëjtën drejtë të ankimit pranë KPMK-së e kanë edhe konkurruesit për punë në Shërbimin Civil të Kosovës, me kusht që para se të ankoheshin në KPMK, duhej të ankoheshin në Komisionin e ankesave të institucionit ku kanë aplikuar për punë.

Sapo të vijë një ankesë në KPMK ajo regjistrohet në Sekretariatit e tij dhe pas protokollimit procedohet për vendosje ne këshill.

Një komision i këshillit prej tre anëtarësh, në emër të këshillit ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për zgjedhjen e lëndës së ankesës duke përfshirë : shqyrtimin e provave të paraqitura në lëndë, organizimin dhe aranzhimin e seancave dëgjimore, dëgjimin eventual të dëshmitarëve, hartimin e procesverbaleve te seancave dëgjimore, mbajtjen e seancës për këshillim dhe votim dhe përfundimisht nxjerrjen e VENDIMIT për lëndën konkrete të ankesës;(shiko një shembull të ankesës të arritur në KPMK-fleta e parë)


Në periodën kohore për të cilën raportohet, pra në vitin 2007 në sekretariatit e KPMK-së janë regjistruar 384 ankesa dhe menjëherë pas ndërmarrjes së proceduarave tekniko-administrative të protokollit janë proceduar për vendosje ne këshill.

Sipas gjinisë :

-femrore	82 ose 21,3%
-mashkullore	296 ose 77%
-tjera AP	06 ose 1.56%

Sipas përkatësisë nacionale të parashtruesve të ankesave:

- shqiptarë	374 ankues ose 97.4%
- serbë	3 ose ankesë ose 0.78%
- boshnjakë	2 ose ankesë ose 06 %
- turq	1 ankesë ose 0.26%
- të tjerë (A.punëdhënëse)	4 ankesa ose 1.04%.



Nga shifrat e cekura më lart shihet qartë se në KPMK kanë arritur më shumë ankesa të gjinisë mashkullore bile herë më shumë se sa nga gjinia femërore ,dhe gjithashtu është një fakt tjetër inkurajues se në KPMK arrijnë ankesa të të gjitha nacionaliteteve edhe pse në numër më të vogël megjithatë është një indikator se shërbyesit civil i besojnë këtij organi pa marrë parasysh gjininë apo përkatësinë nacionale.



Moje zalaganje i rad su do sada visoko ocenili OSCE, UNMIK ,KFOR , kao i drugi cinioci.

Stoga

**P R E D L A Z E M**

Da Nadzorni nezavisni savet, zalbu uvazi kao **osnovanu** i ozalbene odluke preinaci a samim tim meni omoguci da nesmetano I normalno radim na dosadasnjim poslovima i radnim zadacima ili predmet vratiti prvostepenom organu na ponovno razmatranje..

U Gnjilanu 11.04.2007 g.

Podnosilac Zalbe  
*Mladen Mitrović*  
Mladen Mitrović/zam. direktora LKZ



## PËR ÇFARË ARËSYE PALET ANKOHEN NË KPMK

Arsyet pse shërbyesit civil ankohen në KPMK, janë të ndryshme. Gjatë vitit 2007 shumica dërmuese e ankesave kanë pasur dy baza ankimore: ndërprerjen e kontratës së punës dhe mosvazhdimin e kontratës së punës mbas skadimit të afatit kohor.

Po ti hidhet një vështrim tabelës dhe diagramit që pasqyron këtë temë do të konstatohet se numri i ankesave të paraqitura në Këshill për këto dy arsye është gati i njëjtë 127 shkak i ndërprerjes së kontratës dhe 138 shkak i mosvazhdimin të sajë.

Shkaku kryesor pse autoritetet punëdhënëse kanë ndërmarrë këto dy veprime juridike ka qenë mungesa e mjeteve buxhetore gjegjësisht vendimi i Qeverisë së Kosovës për implementimin e rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtarë për zvogëlimin e numrit të shërbyesve civil si sasia e mjeteve monetare të alokuara për paga të punonjësve nga Ministria e Financave për Autoritetet Punëdhënëse që ka qenë më e vogël se viti paraprak buxhetor.

I ndodhur para kësaj situate sfiduese Këshilli ka pasur vetëm një pikësynim që edhe në këto kushte të kërkojë respektimin maksimal të ligjit duke bërë dallimin e qartë në mes të situatës kur kontrata e punës së një shërbyesi civil është ndërprerë para skadimit të afatit kohorë për të cilin ajo është lidhur dhe situatës kur një kontratë pune nuk është vazhduar nga organi punëdhënës në SHCK pasi që ka skaduar afati i sajë.

Të gjitha ankesat të cilat janë ndërprerë para se të skadojë afati kohor kontraktues janë aprovuar në dobi të palëve ankuese dhe autoriteti punëdhënës është obliguar me vendim të KPMK-së të respektojë dispozitat e kontratës në të cilën është palë kontraktuese dhe që nëpunësit civil ti mundësojë ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe obligimeve në përputhje me kontratën e punës së nën shkruar. Ky lloj i vendimit është marrë nga komisionet përkatëse të KPMK-së në të gjitha rastet kurë shkak kryesor i ndërprerjes-shkëputjes së njëanshme të kontratës së punës ka qenë sipas punëdhënësit mungesa e mjeteve buxhetore.


As legjislacioni bazë mbi Shërbimin civil (Rregullorja 2001/36 dhe Urdhëresa Administrative 2003/2) e as legjislacioni sekondar-ndihmës udhëzimet administrative nuk parashohin mundësi të ndërprerjes së kontratës së punës brenda afatit kohor për të cilin është lidhur pos në rast të procedurave disiplinore të zhvilluara ndaj shërbyesit civil pas të cilave eventualisht do të shqiptohej masa disiplinore ndërprerje e punës(neni 30.2 f UA 2003/2)nga komisioni disiplinor i organit punëdhënës apo në rast të vlerësimit negativ të punës pas apo gjatë punës provuese 3 mujore të shërbyesit civil e në të gjitha rastet e aprovuara të ankesave nuk kishim asnjërin nga këto dy veprime.

Ky lloj i vendimeve për ndërprerjen e kontratës së punës ka qenë sidomos karakteristike e Këshillit Gjyqësor të Kosovës i cili ka cilësinë e organit punëdhënës për shërbyesit civil të Gjykatave të Kosovës dhe për të cilin në pjesën e raportit ku shtjellohet zbatimi i vendimeve të KPMK-së do të jepet një pasqyrë e veçantë me shembuj real dhe të dokumentuar.

Në tabelën dhe diagramin e më poshtëm paraqitet pasqyra e tërësishme e ankesave të arritura sipas natyrës së tyre:

- ndërprerje të kontratës së punës	127 ose 33%
- mosvazhdim i kontratës së punës	138 ose 35.9%
- kontestim konkursi	40 ose 10.4%
- degradim posti – Pozite	11 ose 2.86%
- kompensimi Material	26 ose 6.7%
- suspendimi nga puna	05 ose 1.3%
- të natyrave tjera	37 ose 9.6%

(shiko diagramin që pasqyron gjendjen në mënyrë grafike)



Sikur mund të shihet arsye tjera pse palët ankohen në Këshill janë edhe bindjet e konkurruesve për punë në Shërbimin Civil të Kosovës se gjatë procesit të rekrutimit për plotësimin e ndonjë pozite të lirë të punës janë bërë parregullsi gjegjësisht nuk janë zbatuar parimet udhëheqëse të LSHCK dhe kriteret e parapara me Urdhëresën Administrative 2003/2.

Konkurruesit për punë zakonisht atakojnë vendimin e komisionit intervistues duke theksuar se ai-ajo (ankuesi) padrejtësisht nuk është përzgjedhur në pozitë edhe pse i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe se më rastin e zhvillimit të procesit të rekrutimit është shkelur parimi udhëheqës i *meritës* paraparë me nenin 2.1 të Rregullores mbi Shërbimin Civil.

Gjatë zgjedhje se këtyre ankesave komisionet e KPMK-së përpos pretendimeve ankimore të ankuesve të parashtruara në ankesë *ex officio* vërtetojnë përmbushjen e kriterëve ligjore të parapara me dispozita ligjore si: përmbajtja e shpalljes publike, përbërja e komisionit

interviewees, the number of candidates who have competed and on the basis of four facts a decision is made on merit.


The collection of all appeals filed against the classified by the criteria of the Authority of the Appeal against which the appeal is filed is reported according to the following notes:

Organet punëdhënëse kundër të cilave janë parashtruar ankesat:

- Të ushtruara kundër : - ministrive ..... 183 ankesa ose 47.6%
- agjensive ekz..... 12 ankesa ose 3.1%
- komunave ..... 180 ankesa ose 46.8%
- ombudspersonit .....1 ankesë ose 0.5%
- zyra e kryeministrit ..... 1 ankesë ose 0.5%
- të tjera (spitale raj. ATK,UP..... 7 ankesa ose 1.8%

Ankesat e ushtruara kundër AP

- Ankesat e ushtruara kundër ministrive 183 ose 47,6%
- Ankesat e ushtruara kundër komunave 180 ose 46,8%
- Ankesat e ushtruara kundër agjencioeve ekzekutive 12 ose 3,1%
- Ankesat e ushtruara kundër Ombudspersonit 1 ose 0,5%
- Ankesat e ushtruara kundër ZKK 1 ose 0,5%
- Të tjera 7 ose 1,8%



## **AUTORITETET PUNËDHËNËSE KUNDËR TË CILAVE JANË PARAQITUR MË SHUMË ANKESA**

Gjatë procesit të zgjedhjes së ankesave komisionet e Këshillit kanë konstatuar se janë disa autoritete punëdhënëse nga të cilat vijnë më shumë ankesa në KPMK dhe nga renditja e më poshtme mund të konstatohet se cilat janë ato:

- Këshillit Gj.Kos.	58 ankesa ose 15%
- KK. Ferizaj	32 ankesa ose 8.8%
- M.PM Soc.	30 ankesa ose 7.8%
- KK.Gjilan	20 ankesa ose 5.5%
- QKUK	20 ankesa ose 5.5%
- MASHT	13 ankesa ose 3.4%
- KK. Malishevë	11 ankesa ose 2.8%

Pra nuk është e vështirë të konstatohet se numri më i madh i ankesave vijnë nga tri fusha të caktuara ku punojnë shërbyesit civil:Këshilli Gjyqësor i Kosovës,lëmia e arsimit dhe lëmia e shëndetësisë.

### **VENDOSJA E ANKESAVE NË KPMK**

Sikur u theksua edhe në pjesën e tabelave të paraqitura në fillim të këtij raporti komisionet përkatëse të KPMK-së gjatë vitit 2007 kanë zgjedhur gjithsejtë 386 ankesa prej të cilave të vitit 2007 janë 294 ankesa e të viteve paraprake dhe 92 vitet paraprake .

Bazuar në legjislacionin ekzistues KPMK vendos për mënyrën e zgjedhjes së ankesës. Komisioni përbërë nga tre anëtarë të këshillit mundet të vendosë një ankesë në bazë të fakteve (provave të paraqitura në lëndë nga ana e ankuesit dhe përgjigjes në ankesë nga autoriteti punëdhënës të cilës ia bashkëngjit provat me të cilat disponon (neni 5.7 i Udhëzimit Administrativ2005/2 –Mbi procedurat e ankimit në KPMK) apo të thërras një seancë dëgjimore në të cilën palëve pos fakteve të paraqitura në formë të shkruar u jepet rasti të deklarohen drejtpërsëdrejti para komisionit kompetent të këshillit.

Në rastet kur ka konflikt të fakteve materiale dhe kur komisioni konstaton se është e nevojshme që të organizohet seanca e shqyrtimit përgatitor-kryesor për dëgjimin e palëve ,atëherë sekretariati i KPMK ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që kjo seancë aranzhohet duke i njoftuar palët për datën dhe vendim e mbajtjes së seancës dëgjimore.

Seancat dëgjimore të Këshillit mbahen në një sallë të këshillit që në fakt është një zyrë e vogël e cila pos komisionit ,procesmbajtësit dhe të dy palëve në kontest vështirë se mundëson pjesëmarrjen e publikut apo të mediave shkaku i hapësirës së pamjaftueshme edhe pse në disa raste kjo është kërkuar nga palët. Ndërsa në bazë të dispozitave ligjore seancat dëgjimore të Këshillit janë publike.

(shih foton e një seance në KPMK)



Numri i tërësishëm i ankesave të vendosura-zgjedhura në vitin 2007 është 386 Ankesa ,të paraqitura në mënyrë tabelore duken siç vijon:

#### **Sipas mënyrës se si janë zgjedhur**

- Ankesa të aprovuara	78 raste ose 20.2%
- Ankesa të aprovuara pjesërisht	33 raste ose 8.5%
- Ankesa të refuzuara	193 raste ose 50%
- Ankesa të hedhura	60 raste ose 15.5%
- Në forma tjera në	22 raste ose 5.7%

#### **Sipas gjinisë:**

-Të gjinisë Femërore	90 ose 23.3%
- Të gjinisë Mashkullore	293 ose 75.9%
-Të tjera nga A.P.	04 se 1.0%

#### **Sipas përkatësisë nacionale të ankuesit:**

- shqiptarë	375 ose 97.1%
- serb	02 ose 0.5%
- të tjera	04 ose 77.7%
- të tjera nga AP.	05 ose 1.2.%

Nga numri i tërësishëm të lëndëve të vendosura-zgjedhura në vitin 2007 . Janë 294 lëndë të vitit 2007 dhe janë 92 të viteve paraprake.



## ZBATIMI I VENDIMEVE TË KPMK-së NGA ORGANET PUNËDHËNËSE

Vendimet e KPMK-së janë të obligueshme për tu zbatuar nga organet punëdhënëse në Shërbimin civil të Kosovës. Sipas nenit 11.3 të Rreg. 2001/36 përgjegjës për zbatimin e VENDIMEVE të KPMK-së janë sekretarët e përhershëm të Ministrive dhe Përgjegjësit kryesor të Organit të punësimit përkatës( kryeshefat ekzekutivë).

Në krahasim me vitin 2007 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës kanë arritur numër më i madh i ankesave dhe gjithashtu është zgjedhur numër më i madh i ankesave të arritura por është vërejtur edhe rritja e numrit të vendimeve të pa zbatuara nga organet punëdhënëse:

**Cilat janë organet punëdhënëse që shquhen për moszbatimin e vendimeve**

**Të vendimeve të Këshillit:**

Gjatë shqyrtimit të njoftimeve për moszbatimin e Vendimeve të Këshillit KPMK ka vërejtur se disa organe punëdhënëse në SHCK, dallohen për numrin e vendime të pazbatuara dhe në disa raste edhe për injorancën ndaj këtyre vendimeve e sidomos:

- Këshilli gjyqësor i Kosovës,
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe
- Komuna e Malishevës

**Organet që respektojnë vendimet e KPMK-së**

Në anën tjetër është kënaqësi të specifikosh organet të cilat jo vetëm që zbatojnë vendimet e Këshillit por edhe janë gjithmonë të gatshme për një bashkëpunim korrekt , e sidomos:

- Agjencia Pyjore e Kosovës,
- Komuna e Suharekës dhe
- Komuna e Shtimes

Natyrisht në të dyja rastet u përmenden vetëm shembujt që dallohen sepse ka edhe organe tjera punëdhënëse që mundë të përfshihen në këto dy kategori të theksuara më lartë.

(Kopje e një vendimi të KPMK-së dhe njoftimi për zbatimin e tij)



INSTITUCIONET E PËRKOHËSHME VETQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI  
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR KOSOVA

**Nr. 02/138/2007**

Komisioni i KPMK-së në përbërje: Bisera Spahi kryetare, Mursel Ahmeti dhe Nebojsa Azdejković anëtarë të komisionit, në rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit nr. 02/135/2007 e datës 27.3.2007 të parashtruar nga z.Nexhat Berisha nga komuna e Suharekës ,në çështjen juridike të kontestimit të vendimit mbi ndërprerjen e kontratës së punës, pas shqyrtimit gjithëpërfshirës të provave të ofruara, në seancën jopublike të mbajtur më 30.3.2007 në bazë të nenit 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/36, lidhur me nenin 5.7 të U.A. të MSHP-së (nr 2005/2), merrë këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET** ankesa e e ankuesit z.Nexhat Berisha nga komuna e Suharekës.
- II.OBLIGOHET** - Organi punëdhënës që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi ankuesit t'ia mundësojë realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës në përputhje me kontratën e punës .
- III.** Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Kryeshefi Ekzekutiv i Kuvendit Komunal Suharekë.
- IV.** Pas ndërmarrjes së masave sipas këtij vendimi, të njoftohet Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës.
- V.** Në rast mosveprimi sipas këtij vendimi KPMK do të njoftojë PSSP dhe Kryeministrin në përputhje me nenin 11.4 ë Rreg 2001/36 mbi SHCK.

## **A r s y e t i m**

Komisioni për shqyrtimin e ankesës së ankuesit z.Nexhat Bersiha nga komuna e Suharekës i ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës , ka mbajtur seancën jopublike për këshillim dhe votim, ka analizuar provat ankimore të ankuesit dhe ka vërtetuar se ankesa është bazuar në ligj.

**Sepse:**

**Neni 35.1. të U.A.2003/2 si bazë juridike për ndërprerjen automatike të marrëdhënies së punës zbatohet në:**

- a) ditën e vdekjes ...
- b) pas skadimit të kontratës...
- c) në bazë të dorëheqjes me shkrim të shërbyesit civil...
- d) kur punësimi i përhershëm të shërbyesit civil nuk është vërtetuar pas skadimit të periudhës provuese.

**Neni 35.2. Punëdhënësi ka të drejtën konfencionale ta ndërpresë kontratën e punës në shërbimin civil:**

- a) si masë disiplinore për shkak të shkeljes serioze të Rregullave të mirësjelljes në përputhje me Kapitullin VII dhe
- b) nga arsyet shëndetësore kur shërbyesi civil në bazë të vërtetimit të komisionit mjekësor nuk është në gjendje të kryejë obligimet e tij/saj për shkak të sëmundjes së gjatë.

Duke i shikuar rregullat ligjore të këtyre neneve të U.A. 2003/2, mund të vërtetohet se nuk ekziston asnjë bazë tjetër ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë kontratës së punës, përveç masës e shqiptuar disiplinore në përputhje sipas procedurës ligjore.

Komisioni për ankesa i KPMK-së ka vërtetuar se në rastin konkret nuk është zbatuar asnjë procedurë disiplinore dhe asnjë masë e shqiptuar disiplinore kundër z. Nexhat Berisha, kështu që nuk ekziston baza ligjore për ndërprerjen e kontratës së punës. Nga kjo rrjedh, se organi i punësimit është i obliguar që të respektojë obligimet nga kontrata e marrëdhënies së punës.

Në bazë të provave faktike dhe juridike të shkresave të lëndës Komisioni për ankesa i KPMK-së, ka vendosur si në dispozitiv.

**KËSHILLA JURIDKE:** Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative. Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Lënda nr. 02/138/07, është vendosur më 11.4.2007, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv të K.K. Suharekë,
- Ankuesit,
- Në dosje e kësaj lënde.

Prishtinë, 11.4.2007

Përktheu:  
Shemsedin Mujko  
Më, 16.4.2007



**Komisioni i KPMK-së:**


1. Bisera Spahi, kryetare,
2. Nebojsa Azdejković, anëtar,
3. Mursel Ahmeti, anëtar.





KUVENDI I KOMUNËS  
KRYESHEFI EKZEKUTIV

02 Nr. 234  
Suharekë, më 30.04.2007



Nga : Agim Zenelaj – Kryeshef Ekzekutiv

MINISTRIA E SHËRBIMIT PUBLIK- KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS MINISTARSTVO JAVNA SLUŽBA NEZAVISNI NADZORNI ORGAN MINISTRY OF PUBLIC SERVICES- SUPERVISORY OVERSIGHT BOARD		02.05.2007	1/2
Proshkrimi Klasifikimi	Organizimi Organizimi Organizimi	Organizimi Organizimi Organizimi	Organizimi Organizimi Organizimi
Shtetshkrimi		969/07	

Për: Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës – Prishtinë

Lënda: Njoftim

Lidhur me lëndën e z.Nexhat Berishës me nr. Të referencës nr.02/138/2007 ju njoftojmë se e kemi pranuar vendimin e KPM-së dhe njëherit pranojmë ta ekzekutojmë këtë vendim, z.Nexhat Berishën do ta sistemojmë në vendin e mëhershëm të punës.

Me përshëndetje.



KUVENDI I KOMUNËS  
KRYESHEFI EKZEKUTIV  
02. Nr. 234  
SUHAREKË, më 30.04.2007



Duke u bazuar në nenin 49 të Statutit të Komunës së Suharekës,  
Kryeshefi Ekzekutiv me datë 30.04.2007 merr këtë:

### AKTVENDIM

- I. Nexhat Berisha nga Suhareka sistemohet në vendin e punës pastrues në shkollën e mesme teknike “Skender Luarasi” në Suharekë.
- II. Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset Drejtoria komunale e Arsimit në Suharekë.
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

### Arsyetim

Duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës me nr. të referencës nr.02/138/2007 Kryeshefi Ekzekutiv vendosi që z.Nexhat Berisha të kthehet në vendin e mëhershëm të punës konform vendimit të KPM-së, andaj edhe u vendos si në nenin I të këtij aktvendimi.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria komunale e Arsimit në Suharekë.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Të njohohen;  
KPM, DKA  
Evidenca



Kryeshefi Ekzekutiv  
*Agim Zenelaj*  
Agim Zenelaj

Vlen absolutisht të përmendet si rast pozitiv që e vërteton tezën se “**drejtësia vonon por fiton**” faktin se Komuna e Vushtrrisë më në fund ka ndërmarrë masa për implementimin e dy vendimeve të KPMK-së të cilat janë të pazbatuara nga viti 2006 dhe që përmenden në të gjitha raportet e Këshillit si Vendime të pazbatuara. (**shiko kopjen e konkluzionit të KK-Vushtrri**).



Duke iu referuar shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal -V- Nr.02-174/1 të datës 22.08.2007 lidhur zbatimin e Vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës Nr.17,18,19,20/2006 dhe Vendimit Nr.02/16/2006, bazuar në nenin 11.3 të Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 88 dhe 96 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 27.09.2007 mori këtë:

### KONKLUZION

Për zbatimin të Vendimeve të Këshillit të pavarur Mbikëqyrës të Kosovës  
Nr.02/16/2005 dt.18.07.2006 dhe nr.17,18,19,20/2005, dt.15.06.2005

1. OBLIGOHEN: Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës, Avokati Publik dhe Drejtori i Drejtorisë për Thesar Buxhet dhe Financa që menjherë të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe ate:
  - a. Vendimi i KPMK Nr.02/16/2005, dt.18.07.2006, përkatësisht pika 3 e dispozitivit të këtij vendimi me të cilin z. Esret Uka të i realizoj të drejtat nga mardhënja e punës në përputhje me kontratën e punës nr.06/2003 dt. 25.04.2003, për kohën për të cilën nuk ka punuar dhe
  - b. Vendimi i KPMK nr.17,18,19,20/2005 të datës 15.06.2005, përkatësisht pika 2 e dispozitivit të këtij vendimi me të cilin z.Besim Jashari, z.Veli Karaqa, z.Bajram Xhafa dhe z.Hysen Sfarqa të i realizojnë të drejtat nga mardhënja e punës, në përputhje me kontratat e tyre të punës – kontrata nr.79/2003, dt.02.07.2003, nr.77/2003 dt.02.07.2003, nr.81/2003 dt.02.07.2003, nr.84/2003 dt.02.07.2003, për kohën për të cilën nuk kanë punuar.

2. Obligohet Drejtoria për Administratë të Përgjithshme – Sektori i Menaxhimit të Personelit që të i ofroj Drejtorisë për Thesar Buxhet dhe Financa kontratat e punës të të përmendurve më lartë duke llogaritur për secilin, periudhën kohore në të cilën nuk kanë punuar deri në ditën e skadimit të kontratës së punës, pasi që ka njoftime se disa prej tyre kanë themeluar marrdhënje të punës në institucione të ndryshme të Kosovës dhe janë duke punuar edhe tani.
3. Ky konkluzion hyn në fuqi në ditën e miratimit në seancë të Kuvendit të Komunës në Vushtrri dhe duhet të zbatohet menjëherë.
4. Me këtë konkluzion njoftohen:
  - z. Lutfi Haziri, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i APL
  - z. Esret Uka, fsh. Dobërllukë – Vushtrri
  - z. Besim Jashari, Rr. “Avni Rrustemi” nr.12 - Vushtrri
  - z. Veli Karaqa, Rr. “Drenica” nr. 9 – Vushtrri
  - z. Bajram Xhafa, Rr. “Bahri Kuqi” - Vushtrri
  - z. Hysen Sfarqa, fsh. Studime e Poshtme – Vushtrri
  - z. Muharrem Parduzy, Kryeshef Ekzekutiv
  - z. Ekrem Salihu, Avokat Publik
  - z. Isuf Jashari, Drejtor i Drejtorisë për Thesar Buxhet dhe Financa dhe
  - z. Bislim Dushi, Menaxher i Personelit në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme në Vushtrri.

Kryetari i Kuvendit




Muharrem Shabani

KPMK-ja nga palët që kanë parashtruar një ankesë informohet që VENDIMI i këtij organi nuk është zbatuar nga Autoriteti i caktuar punëdhënës në SHCK dhe posa ta marrë njoftimin ndërmerr përpjekje shtesë për të siguruar zbatimin e atij vendimi duke i sqaruar organit të punësimit se pse është e domosdoshme që ky vendim të zbatohet dhe duke e paralajmëruar për pasojat e moszbatimit të tij. Në raste konkrete kjo përpjekje shtesë jep rezultate si p. sh .me rastin e zbatimit të Vendimit që kishte të bëjë me ankuesen z. Lule Kastrati nga Peja ku pas vizitës së anëtarëve të KPMK-së në KK-Pejë ky vendim u zbatua.

Por ka raste kur as këto sqarime e përpjekje nuk japin rezultat dhe rasti i moszbatimit të vendimit të Këshillit i referohet PSSP-së dhe Kryeministrit të Kosovës që është obligim i Këshillit në bazë të nenit 11.4 të Rregullores 2001/36.



(shih kopjen e një njoftimi dhe përgjigjen e PSSP)



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVES / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI  
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR KOSOVA

Për Z.Joachim Rucker. Kryeadministrator i Kosovës  
Nga: Sevdail Kastrati, kryetar i KPMK-së

Lënda: Informatë

I nderuar Kryeadministrator në duke u bazuar në nenin 12 par.1 pika (c) të Rreg 2001/36 mbi Shërbimin civil të Kosovës ,e me qëllim të informimit të ndërsjellë ju informoj si më poshtë:

Komisioni i Këshillit i Pavarur Mbiqyrës në përbërje Z.Bajram Zogiani-kryetar,znj, Bisera Spahi dhe znj.Flora Balidemaj anëtare duke u ushtruar funksionin e tij të vëzhgimit zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve në KK-Klinë me datë 27.06.2007 ka konstatuar se procesi i zgjedhjes së këtyre drejtorëve ka amngësi serioze juridike andaj ka REKOMANDUAR përsëritjen e tij duke eliminuar të metat e konstatuara.

Pas konsultimit të panelit intervistues dhe kryetarit të Kuvendit Komunal është marrë vendimi që të përsëritet shpallja por pasi ka dalë komisioni i KPMK-së ,komisioni intervistues i KK-Klinë ka vazhduar procesin dhe ka intervistuar kandidatët që kan kjonkurua dhe i ka rekomandua Kuvendit Komunal zgjedhjen e drejtoëve të drejtorive komunale të cilën gjë Asambleja Komunale e KK-Klinës e ka bërë me datë 29.06.2007 duke zgjedhur 10 drejtorë të drejtorive komunale.

Vërejtjet e komisionit vëzhgues të KPMK-së kanë qenë:

I. Se konkursi publik nuk është shpallur konform nenit 4 të UA 2003/2

II.Se komisioni intervistues nuk është emëruar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenin 76 të vet statutit të KK-Klinë ku parashihet që panelin intervistues e cakton Kuvendi Kumunal dhe se udhëhiqet kryetari i Kuvendit e në rastin konkret ky panel sipas vendimit 1/3 Nr 112-2477 është emëruar nga kryeshefi ekzekutiv dhe është udhëhëqur nga vet ai.

III. Përbërja e komisionit intervistues nuk ka qenë në përputhje me nenin 7.2 të UA 2003/2 (komisioni ka qenë i përbërë vetëm nga meshkujt pra pa barazi gjinore dhe etnike) ndërsa Autoriteti Punëdhënës nuk ka ofruar ndonjë deklaratë me shkrim që do të arsyetonte mos aplikimin e parimit të shumllojshmërisë që është obligim sipas nenit 7.3 të të njejtit UA.

Nga të dhënat e mësipërme del se me këto veprime KK-Klinë nuk ka rrespektua:

Rekomandimet e KPMK

Këshillën ligjore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Reeg e UNMIK-ut 2000/45

Rreg. e UNMIK-ut 2001/36

UA.2003/2 për zbatimin e rreg.2001/36

Nga e tëra kjo KPMK-konkludon se emrimi i drejtorëve të drejtorive komunale në KK-Klinë është bërë duke shkelur parimet e Shërbimit Civil të Kosovës të parapara me nenin 2.1 të Rreg 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës .

Konsiderojme se moszbatimi i vendimeve të Këshillit pos që është shkelje e dipozitave të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës ,është edhe shenjë jo e mirë për parimin e sundimit të ligjit në shoqëri.

Duke qenë se sipas Ligjit jeni ju garantues i zbatimit të VENDIMVE të Këshillit të Pavarur, sinqerisht ju lus që të ushtroni angazhimin tuaj për zbatimin e këtyre vendimeve.

Duke ju falenderuar paraprakisht për mbështetjen për KPMK ju përsërisht dhe ripërsërisht gadishmërinë e Këshillit për bashkpunim në të gjitha fushat ku shifet e nevojshme nga ana e juaj në intres të përgjithshëm të krijimit të një Shërbimi Civil efikas, profesional me veprime të bazuara në ligj dhe mbi të të gjitha në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

Shtojcë: kopjet e vendimeve dhe dokumentacioni përcjellës.

Me rrespekt: Sevdail Kastrati



31 August 2007

Dear Mr. Kastrati,


I refer to your letter reporting the failure of the Municipality of Klinë/Klina to implement certain decisions of the Independent Oversight Board of Kosovo, as provided for in Article 11.4 of UNMIK Regulation No. 2001/36 on the Kosovo Civil Service. I concur with you that it is important to uphold the rule of law in the municipal administration of Klinë/Klina.

Under the applicable legislation, the Ministry of Local Government Administration (MLGA) has the authority to take remedial action on the basis of UNMIK Regulation No. 2007/18 of 9 May 2007 amending UNMIK Regulation No. 2001/19, Annex XIV which sets out the supervisory functions of the MLGA.

Please be informed that UNMIK has contacted the Ministry with the aim to promote and enhance compliance by the Municipality with IOB decisions in accordance with the applicable law.

I thank you and your fellow board members for the important work you do in promoting the governing principles of the Kosovo Civil Service and wish you every success in continuing your work.

Yours sincerely,



Joachim Rücker

Special Representative of the Secretary-General

Mr. Sevdail Kastrati  
Chairperson  
Independent Oversight Board

cc: Mr. Lutfi Haziri, Minister of Local Government Administration

Një Organ i Punësimit i veçantë në moszbatimin e Vendimeve të Këshillit të pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2007 është dalluar dukshëm duke mos zbatuar 21 Vendime të KËMK-së. Bëhet fjalë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës nga i cili duke ditur rolin e tij ,nuk kemi pritur se do te ketë një mospërfillje totale të vendimeve të Këshillit.

Në fakt nga ky organ kemi marrë 58 ankesa prej të cilave 21 janë aprovuar në dobi të palëve sepse kontratat e punësimit u ishin shkëputur njëanshëm para skadimit të afatit kohor për të cilin ishin lidhur me të vetmin justifikim se nuk kishte mjete buxhetore për pagesën e të ardhurave personale për punëtorët të cilëve iu shkëput kontrata e punës.

KPMK, duke udhëhequr procedurat e parapara për zgjedhjen e këtyre ankesave kishte konstatuar se absolutisht nuk ishin përmbushë kushtet ligjore për shkëputjen e tyre sepse ndaj të punësuarve nuk ishte udhëheq asnjë procedurë disiplinore, nuk ishte bërë vlerësimi negativ për kryerjen e detyrave të punës dhe organi punëdhënës nuk kishte paraqitur prova për mungesë buxheti. Asnjë dispozitë nuk ligjore nuk parasheh të drejtën e shkëputjes së kontratës përpos në rastet taksative të paraparë me ligj e që në Këshillin Gjyqësor nuk ishin përmbushur.

Për më shumë Këshilli Gjyqësor kishte informuar KPMK dhe nuk është në gjendje të zbatojë vendimet e tij sepse është në mungesë të mjeteve buxhetore.



(shiko kopjen e një vendimi të Këshillit gjyqësor, të një vendimi të Këshillit të Pavarur dhe njoftimin e Këshillit gjyqësor për moszbatimin e vendimeve)



KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUĐSKI SAVET KOSOVA

Referencë: 02/118-651

Bazuar në vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, referencë 03/118-591 të datës 15/12/2006, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, merr këtë:

V E N D I M

**Afrim Zhubi**, recipionist në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje Gjakovë, i ndërpritet kontrata e punës më 20/04/2007.

Nëse i ka ngelur e pashfrytëzuar ndonjë ditë e pushimit vjetor, do t'i kompensohet në vlerën e ditëve të pashfrytëzuara.

Inventarin me të cilin ka qenë i ngarkuar është i detyruar që të ta kthejë duke përfshirë edhe kartelën identifikuese.

A r s y e t i m

Duke u nisur nga përcaktimi për reformimin e Sistemit Gjyqësor të Kosovës, në përgjithësi dhe reformimin e administratës gjyqësore në veçanti, si dhe reduktimet buxhetore për 156 pozita të shërbyesve civil në institucionet gjyqësore për vitin 2007, Këshilli Gjyqësor i Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Reduktimi i pozitave është bërë në parim në të gjitha institucionet gjyqësore, ku këto pozita kanë qenë më pak të shfrytëzuara dhe që nuk kanë ndikuar qenësisht në procesin e punës.

Nga ajo që u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli obligon sekretariatën që të zbatojë këtë vendim konform ligjit mbi Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007.

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë t'i ushtrojë ankesë Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

T'i dërgohet:  
1 kopje palës  
1 kopje arkivit  
1 kopje personelit



FRANOVA VENDIMIN SOT ME

24.04.2007

AH



1745/07  
30.08.2007  
Prishtine, Prishtine, Prishtine



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTERIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI  
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVO  
INDEPEDENT OVERSIGHT BOARD KOSOVO**

**Nr. 02/273/2007**

Komisioni i KPMK-së në përbërje: Nebojsa Azdejković kryetar, Mursel Ahmeti dhe Bisera Spahi anëtarë të komisionit, në rastin e rishqyrtimit të ankesës së ankuesit z.Afrim Zhubi, nr. 02/273/2007 e datës 7.8.2007, të parashtruar nga komuna e Gjakovës, lidhur me çështjen juridike të kontestimit të vendimit mbi ndërprerjen e kontratës së punës. Pas shqyrtimit gjithëpërfshirës të provave të ofruara, në seancën jopublike të mbajtur më, 23.8.2007, në bazë të nenit 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/36, lidhur me nenin 5.7 të U. A. të MSHP-së (nr. 2005/2), merr këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET** ankesa e ankuesit z. Afrim Zhubi, nga komuna e Gjakovës.  
**Anulohet vendimi** nr. 03/118/451 i Organit punëdhënës mbi ndërprerjen e kontratës së punës dhe vendimi i komisionit për ankesa KA nr. 61/2007.
- II. OBLIGOHET** - Organi punëdhënës që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, ankuesit t'ia mundësojë realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës në përputhje me kontratën e punës.
- III.** Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- IV.** Pas ndërmarrjes së masave sipas këtij vendimi, të njoftohet Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës.
- V.** Në rast mosveprimi sipas këtij vendimi KPMK do të njoftojë PSSP dhe Kryeministrin në përputhje me nenin 11.4 të Rreg 2001/36 mbi SHCK.

## Arsyetim

Komisioni i KPMK-së e ka shqyrtuar ankesën e ankuesit të z. Afrim Zhubi nga komuna e Gjakovës, i ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka mbajtur seancën jopublike për këshillim dhe votim, ka analizuar provat ankimore të ankuesit dhe ka vërtetuar se ankesa është bazuar në ligj.

Sepse:

**Sipas nenit 35.1. të U.A.2003/2, si bazë juridike për ndërprerjen automatike të marrëdhënies së punës zbatohet:**

- a) me rastin e vdekjes,
- b) pas skadimit të kontratës,
- c) në bazë të dorëheqjes me shkrim të shërbyesit civil dhe
- d) kur punësimi i përhershëm të shërbyesit civil nuk është vërtetuar pas skadimit të periudhës provuese.

Duke i shikuar rregullat ligjore të këtyre neneve të U.A. 2003/2, mund të vërtetohet se nuk ekziston asnjë bazë tjetër ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë kontratës së punës, përveç masës së shqiptuar disiplinore në bazë të procedurës ligjore.

Komisioni për ankesa i KPMK-së ka vërtetuar, në rastin konkret nuk është zbatuar asnjë procedurë disiplinore, dhe asnjë masë e shqiptuar disiplinore kundër z. Afrim Zhubi. Andaj, nuk ekziston baza ligjore për ndërprerjen e kontratës së punës. Për këtë arsye Organi i punësimit është i obliguar që ti respektojë obligimet nga kontrata e marrëdhënies së punës.

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më, 11.7.2007, ka shpallur konkursin nr. 02/2007 për pozitën referent nën nr. 8 në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Gjakovë, në të cilën ende punon ankuesi z. Afrim Zhubi, i cili ka kontratën e punës të lidhur me Organin punëdhënës. Duke pasur parasysh se konkursi është i shpallur, kjo tregon se ekziston buxheti për këtë vend pune. I rekomandohet Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të bëjë përmirësimin e konkursit, i cili është shpallur me numrin e cekur dhe ta anulojë pozitën nën pikën nr. 8 dhe për këtë ta informojë KPMK-në.

Në bazë të provave faktike dhe juridike të shkresave të lëndës, Komisioni për ankesa i KPMK-së, ka vendosur si në dispozitiv.

KËSHILLA JURIDKE: Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative.  
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Lënda nr. 02/273/07, është vendosur më 23.8.2007, në Këshillin e Pavarur  
Mbikëqyrës të Kosovës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Ankuesit dhe
- Në dosjen e kësaj lënde.

**Komisioni i KPMK-së:**

Prishtinë, 23.8.2007

1. Nebojsa Azdejković, kryetar
2. Bisera Spahi anëtare,
3. Mursel Ahmeti, anëtar.



Përktheu:  
Shemsedin Mujko *Sh. Mujko*  
Më, 24.8.2007





KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
SUDSKI SA VET KOSOVA



MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE - KËSHILLI I PAVARUR MBIKQYRËS I KOSOVËS MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI NEZAVISNIH NADZORNI ODBOR KOSOVA MINISTRY OF PUBLIC SERVICES - INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR KOSOVO	
Pranuar Prishtinë Received	23. 11 2007
Organizata Organizacija Organization	SKPMN 2246
Shkollë Prilog Attachment	1

**Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës**

Referenca: 03/1123/117  
Prishtinë: 23/11/2007

PËR/ZA/TO	Sevdail Kastrati, Kryetar I Këshillit të Pavarur Mbikqyrës i Kosovës.
NËPERMJET/PREKO/THROUGH	Halit Muharremi, Drejtor i Sekretariatit të KGJK
NGA/OD/FROM	Vahid Limani, Udhëheqës i Departamentit të Administratës dhe Personelit.
LENDË/SUBJEKAT/SUBJEKT	Njoftim, lidhur me mos ekzekutimet (përbushjen) e vendimeve të juaja për rikthimin e shërbyesve civil të reduktuar në vendet e tyre të punës

Lidhur me mos ekzekutimet (përbushjen) e vendimeve të juaja për rikthimin e shërbyesve civil në administratën gjyqësore të reduktuar në vendet e tyre të punës, ju informojm si në vijim:

Me kërkesën tone të dates 29.05.2007 ju kemi informuar se jemi të kufizuar me pozitë dhe mjetet buxhetore nga Qeveria e Kosovës për vitin 2007, çka nënkupton se edhe përkundrejt vullnetit tone të mire jemi në pamundësi të zbatimit të vendimeve tuaja që përkojnë me kthimin e shërbyesve civil në pozitë të reduktuara. Përpos kësaj ne jemi edhe tani duke u ballafaquar me reduktimet buxhetore të vitit 2008.

Përkundrejt kësaj ne mendojmë se për gjithë kontigjentin e shërbyesve civil të shkurtuar duhet të bëhet një zgjidhje unike për të gjitha institucionet.

Me respekt

E pazakonta e rastit është se Këshilli Gjyqësor pasi ka shkëputur kontratat e punës së punonjësve civil nëpër Gjykatat e Kosovës pas një periode të shkurtër kohore në mediat publike ka shpallur 4-5 konkurse publike për të njëjtat pozita shumë të ngjashme për nga emërtimi i postit si të lira duke mos respektuar fare Vendimin e Qeverisë për ngrirje të punësimit. 06/214 dhe udhëzimin administrativ të MSHP2006/12 “Masat për Ngrirjen e Punësimit të Nëpunësve Civil në Organet e Administratës Civile” të nxjerrë nga Ministria e Shërbimeve publike në bazë të Vendimit të qeverisë që i obligon Autoritete Punëdhënëse sidomos me nenin 4.1 ku parashihet se mbulimi i vendeve të lira të behet nëpërmes lëvizshmërisë Është logjiksht e pakapshme e juridikisht e paqëndrueshme të pohohet se nuk ke buxhet për pozitat ekzistuese të cilat pretendonin se do të shuhen e në anën tjetër të shpallën të lira po të njëjtat vende apo shumë të ngjashme, në esencë kjo qartë asocion në dëshirën e punëdhënësit për ndërrim të personave që kanë punuar me persona tjerë.





KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
KESHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor  
Sekretariat Sudskog Saveta  
Secretariat Of Judiciary Council



Mbështetur në nenin 3 të Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe konform nenit 3,4,7 të Urdhresës Administrative nr. 2003/2, zbatim i Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës.  
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor në Prishtinë shpall:

**K O N K U R S**  
Nr. 02/2007

- 1. Shef i zyrës së prokurimit..... 1 pozitë në Sekretariatit e KGJK-së
- 2. Zyrtar i zyrës së prokurimit..... 1 pozitë në Sekretariatit e KGJK-së
- 3. Zyrtar i statistikës..... 1 pozitë në Sekretariatit e KGJK-së
- 4. Zyrtar ligjor..... 1 pozitë në Sekretariatit e KGJK-së
- 5. Administrator..... 1 pozitë në Gjykatën Supreme të Kosovës
- 6. Administrator..... 1 pozitë në Gjykatën Komunale në Istog
- 7. Bashkëpunëtor profesional..... 1 pozitë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë
- 8. Referent..... 1 pozitë në Gjykatën për Kundërvajtje në Gjakovë
- 9. Referent për ekzekutime..... 1 pozitë në Gjykatën Komunale në Dragash
- 10. Referent për ekzekutime..... 1 pozitë në Gjykatën Komunale në Gjiell
- 11. Arkëtar..... 1 pozitë në Gjykatën për Kundërvajtje në Deçan
- 12. Sekretare juridike..... 1 pozitë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë (E rezervuar për minoritetin serb)
- 13. Roje sigurimi..... 1 pozitë në Gjykatën Komunale në Prishtinë-dega në Graçanicë (e rezervuar për minoritetin serb)
- 14. Roje sigurimi..... 2 pozita në Gjykatën Komunale në Klinën (një pozitë me kohë të caktuar deri me 31.10.2007)
- 15. Roje sigurimi..... 1 pozitë në Gjykatën Komunale në Gjakovë
- 16. Roje sigurimi..... 1 pozitë Gjykata Komunale Suharekë
- 17. Roje sigurimi..... 1 pozitë Gjykata Komunale Leposaviq
- 18. Voznë..... 1 pozitë në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë
- 19. Sekretare juridike..... 1 pozitë në Gjykatën Komunale në Prizren

**Përshkrimi i detrave të punës**

**-I-**

Titulli i postit: **Shef i zyrës së prokurimit**  
Njësia: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor  
Kontrata 3 muaj Niveli i pagesë: 293€  
Gjysmë orari: jo  
Nëpunësi mbikëqyrës: drejtori i Sekretariatit të KGJK-së

**Qëllimi i postit:**  
1. Të përgatisë planin e prokurimit për çdo vit, duke i dhënë përparësi kërkesave në konsultim me të gjitha njësitë e sekretariatit.  
2. Bën planifikimin dhe strategjinë e prokurimit për KGJK-në, siguron një prokurim të kualitetit të lartë dhe iniciimin e kontratës me furnizuesin.  
3. Organizon procedurën e kuotimit dhe të tenderit, varësisht nga çmimi i vlerësuar në bazë të limiteve financiare të miratuara sipas ligjit 2003/17.  
4. Përgatit dokumentet e kontratës dhe kushtet e kontratës, duke përdorur format a aprovuara (zyrtare).  
5. Vëzhgon dhe përcjellë (respekton) Instruksionin Administrativ Financiar dhe udhëzuesin për mallra, shërbime dhe punë të lëshuar nga Autoriteti Qendror Fiskal dhe Ministria e Shërbimeve Publike lidhur me prokurimin duke i përdorur Fondet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe të hyrat vetanake.  
6. Asiston në aranzhimin e procedurave dhe krijimin e komisioneve për vlerësim, i cili mund të ndryshojë varësisht prej kompleksitetit të çështjes në fjalë dhe të nevojës për të kërkuar ndihmë të ekspertizës teknike.  
Performon edhe detyra tjera të prokurimit të caktuara nga mbikëqyrësi.

**Përgjegjësi të kyçe:**  
Përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve të zyrës së prokurimit.  
Ofrimi i shërbimit cilësor.

**Shkathësitë, aftësitë dhe përvoja:**  
Shkathësi të dëshmuara të të menduarit strategjik, planifikimit, organizimit dhe menaxhimit.  
Te ketë aftësi dhe njohuri për formulim dhe zbatim të rregullave për mbikëqyrje në aspektin nëse puna e kryer është në pajtim me rregullat dhe procedurat për vendosje të prioriteteve në punë dhe për punë të pavarur.  
Te ketë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkërim dhe me gojë.  
Te jetë entuziast, energjik, transparent dhe të komunikojë mirë me palë.  
Minimumi 2 vjet përvojë pune profesionale në fusha përkatëse apo të ngjashme.  
Njohja e gjuhëve të minoriteteve dhe gjuhës angleze janë përparësi.

**Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë post:**  
1. Diplome fakulteti në lëmin e ekonomisë ose biznesit.  
2. Të ketë licencë për prokurim.

**-II-**

Titulli i postit: **Zyrtar i Prokurimit**

Njësia: Zyra e prokurimit  
Kontrata 3 muaj Niveli i pagesë: 244€  
Gjysmë orari: jo  
Nëpunësi mbikëqyrës: Shefi i zyrës së prokurimit

**Qëllimi i postit:**

- 1. Të përgatisë planin e prokurimit për çdo vit, duke i dhënë përparësi kërkesave në konsultim me të gjitha njësitë e departamentit.
  - 2. Bën planifikimin dhe strategjinë e prokurimit për KGJK-në, dhe siguron një prokurim të kualitetit të lartë dhe iniciimin e kontratës me furnizuesin.
  - 3. Organizon procedurën e kuotimit dhe të tenderit, varësisht nga çmimi i vlerësuar në bazë të limiteve financiare të miratuara (IAF Nr 2/99 për prokurim publik).
  - 4. Përgatit dokumentet e kontratës dhe kushtet e kontratës duke përdorur format a aprovuara (zyrtare).
  - 5. Vëzhgon dhe përcjellë (respekton) Instruksionin Administrativ Financiar dhe udhëzuesin për mallra, shërbime dhe punë të lëshuar nga Autoriteti Qendror Fiskal dhe Ministria e Shërbimeve Publike lidhur me prokurimin, duke i përdorur Fondet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe të hyrat vetanake.
  - 6. Asiston në aranzhimin e procedurave dhe krijimin e komisioneve për vlerësim. Krijimin e komisioneve për vlerësim, mund të ndryshojë varësisht prej kompleksitetit të çështjes në fjalë dhe të nevojës për të kërkuar ndihmë të ekspertizës teknike.
  - 7. Siguron që të mbahen të dhëna të detajuara për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës dhe vendimet e bëra gjatë çdo faqe të procedurës. Të sigurojë që komentet e të gjithë anëtarëve të shënosh dhe çdo anëtar i nënshkruaj këto komente dhe dokumentet e scanuës.
  - 8. Të këshillojë drejtorin e Sekretariatit të KGJK-së dhe udhëhoqsin e zyrës në rast të mos performimit të kontraktuesit/furnizuesit.
- T'i japë ORPP (organit rregullativ për prokurim publik) pranë AQF me detaje majore të gjitha llojet e kontratave duke përfshirë këtu edhe raportin vjetor.  
Performon edhe detyra tjera të prokurimit të caktuara nga mbikëqyrësi.

**Përgjegjësi të kyçe:**  
Përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve të divizionit të prokurimit.  
Ofrimi i shërbimit cilësor.

**Shkathësitë, aftësitë dhe përvoja:**  
Shkathësi të dëshmuara të të menduarit strategjik, planifikimit, organizimit dhe menaxhimit. Aftësi në udhëhoqje dhe menaxhim të ekipeve.  
Te ketë aftësi dhe njohuri për formulim dhe zbatim të rregullave në aspektin e kryerjes së punës në pajtim me rregullat dhe procedurat për vendosje të prioriteteve në punë dhe për punë të pavarur.  
Te ketë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkërim dhe me gojë.  
Të jetë entuziast, energjik, transparent dhe të ketë aftësi të mira komunikuese me palë.  
Minimumi 2 vjet përvojë pune profesionale në fushat përkatëse apo të ngjashme.  
Njohja e gjuhëve të minoriteteve dhe gjuhës angleze janë përparësi.

**Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë post:**  
1. Diplome fakulteti në lëmin e ekonomisë ose biznesit.  
2. Kandidatët duhet të kenë licencë të prokurimit.

**-III-**

Titulli i postit: **Zyrtar i Statistikës**  
Njësia: Departamenti i Statistikës dhe Teknologjisë Informative (DTSI)  
Shkalla: Niveli i pagesë: 212 € Grupi: 6,5  
Kontrata: 36 muaj  
Gjysmë orari: jo

Nëpunësi i mbikëqyrjes: Udhëheqësi i DSTI-së Përgjegjësia mbikëqyrëse: 8 punonjës

**Qëllimi i postit:** Bënë grumbullimin e të dhënave statistikore nga institucionet gjyqësore, bën përpunimin e këtyre të dhënave, përpilon raporte majore, termajore dhe vjetor mbi punën e këtyre institucioneve. Kryen punë të tjera të cilat ia beson Udhëheqësi i Departamentit ose Drejtori i DSTI-së.

**Përgjegjësi të Kyçe:**  
Përgjegjësia mbi grumbullimin e shënimeve dhe saktësin e përpunimit e tyre.  
Ndihmon Zyrtarin për Hululime në përpilimin e formulaveve statistikore dhe udhëzimeve metodologjike për grumbullimin e të dhënave statistikore

5% Grumbullon shënime mbi punën e gjykatave të qarkut,  
5% Grumbullon shënime mbi punën e gjykatave komunale,  
15% Kontrollon saktësinë e të dhënave statistikore dhe për çdo parregullsi e informon Shefin e Seksionit  
Grumbullon shënime mbi punën e gjyqtarit (standartet kohore)

Mbledh shënime statistikore mbi kualitetin, kuantitetin dhe mënyrën e kryerjes së lëndëve nga gjyqtarët dhe gjykatave.  
5% Përgatit datotekat për përpunimin e të dhënave

10% Përpunon të dhënat dhe në bazë të të dhënave të grumbulluara dhe përpilon raporte mbi punën e gjykatave

40%  
**Shkathësitë, aftësitë dhe përvoja:**  
Aftësi për hulumtime statistikore dhe analiza E nevojshme  
Aftësi të dëshmuara të punës me kompjuter E nevojshme  
Aftësi të dëshmuara për të komunikuar me palë dhe shtjellje të mira E nevojshme  
Bashkëpunim ndërkolegjial dhe profesional E nevojshme  
Shkathësi komunikimi në gjuhë joamtare E dëshirueshme  
Shkathësi komunikimi me gojë dhe me shkërim E nevojshme  
Transparenca në punë E nevojshme  
Përvoja e punës në lëmin e statistikës të judikaturës E nevojshme

**Kualifikimet arsimore dhe profesionale për post:**

E tërë kjo gjendje e palejueshme ka krijuar edhe situata të pakëndshme edhe në vetë Gjykatat e Kosovës të cilat përpos që ndajnë drejtësi janë të obliguara edhe të ti përmbahen Drejtësisë dhe Ligjshmërisë. Kryetari i Gjykatës kom ,në Pejë p. sh ka kërkuar nga KPMK sugjerim se si të veprojë në situatën konkrete .duke e ndier veten të ‘hutuar dhe të frustruar “sepse si jurist nuk mund të zbatojë vendimin e një organi të Kosovës që ka të bëjë me institucionin që ai e drejton.



(shiko kopjen e shkresës së kryetarit të Gjykatës komunale në Pejë)

595

INTERIM ADMINISTRATION OF KOSOVA  
ADMINISTRATA E PËRKOSSHME E KOSOVËS  
PRIVREMENA ADMINISTRACIJA KOSOVA

GJYKATA KOMUNALE NË PEJË ]  
II AGJ.NR. 39 /07  
Pejë, me 17.12.2007.

MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS MINISTARSTVO JAVNIH SLUZHBI NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA MINISTRY OF PUBLIC SERVICES AND INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR KOSOVA			
Prismarje, 27.12.2007			
Organizimi	№ i aktit U. Pr. 39/07	Shkronja P. Pr. 39/07	Shtesa Kombëtare Quantity 1/6
SKPMK	2398		

MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
Këshillit të pavarur mbikëqyrës të Kosovës  
Kryetarit të komisionit të KPMK

PRISHTINË

I nderuari z. Kryetar.

Me vendimin ref.03/118-181/07 dt. 15.12.2006, punëtorit të kësaj gjykate Isa Berisha shtëpiak në Gjykatën Komunale në Pejë i është ndërprerë kontrata e punës me 31.12.2006, që do të thotë se i ndërpritet Mardhania e punës për vitin 2007.

Ankesa e punëtorit Isa Berisha me nr. 1885 dt. 25.09.2007, nga ana e Këshillit të pavarur mbikëqyrës të Kosovës është aprovuar dhe anuluar vendimi nr. dhe datë lartcekur, lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe vendimi i komisionit të ankesave KA.nr. 13/07 dt. 22.03.2007, si të pabazuara në lidhje me ndërprerjen e kontratës së punës. Metej nën pikën 2 të vendimit është obliguar Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës që nëpunësin ta kthejë në punë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga kontrata e punës, pra nëpunësit duhet të ia kompensoi të gjitha pagat mujore në mënyrë retroaktive duke filluar nga dt. 31.12.2006, e deri në vazhdimin e rregullt të pagës.

Nën pikën 3 në vendim është cekur se nëpunësi duhet të kthehet në punët dhe detyrat e punës sipas kontratës së punës apo në vend tjetër të punës me kualifikim dhe pagë të njejt.

Në pikën 4 të vendimit është cekur se përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është drejtori i SKGJK-së.

Në pikën 5. është cekur se pas ndërrmarjes së masave sipas këtij vendimi të njoftohet Këshilli i pavarur mbikëqyrës i Kosovës dhe

Pika 6. në rast mosveprimit sipas këtij vendimi KPMK, do të njoftojë PSSP dhe Kryeministrin e Kosovës, në përputhje me nenin 11.4. të Rregullores 2001/36 mbi SHCK për ndërrmarjen e masave të mëtejme.

Unë si Kryetar i gjykatës jam i hutuar, frustruar dhe i zhgënjyer me mosveprimin e sipas vendimit të lartcekur, ngase qysh para marrjes së vendimit në fjalë Sekretariati i KGJK-së referencë 03/118-722 dt. 11.07.2007, me një akt të

Edhe ministria e Kulturës ,Rinisë dhe Sporteve ka dështuar të zbatojë vendimet e KPMK-së bile në një rast konkret publikisht me një vendim të U.D të Sekretarit Permanent z.Mon Zhubi përkundër të gjitha normave ligjore që rregullojnë shërbimin civil ka **REFUZUAR** zbatimin e **VENDIMIT** të KPMK-së nr 879/07 me të cilin është aprovuar ankesa e znj. Minire Zeka punëtore e kësaj Ministrie, që është absolutisht e palejueshme për më shumë sepse kjo ministri ka mundur të shfrytëzojë mjetet juridike të ankimit dhe jo të refuzojë në këtë mënyrë zbatimin e vendimit,edhe ky rast është raportuar tek PSSP dhe Kryeministri.

(kopja e vendimit jo ligjor të MKRSCJR )

UNMIK

IPVK

INSTITUCIONET E PËRKOZHME TË VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVA  
VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT

SEKRETARI I PËRHERSHËM

2241/2007  
23. 11. 2007  
Pallesi

Ministria e Shqipërisë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Ministria e Shqipërisë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Ministria e Shqipërisë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Ministria e Shqipërisë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Ministria e Shqipërisë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Ministria e Shqipërisë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Ministria e Shqipërisë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Ministria e Shqipërisë	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

SKPMK 2255 916

Në bazë të nenit 5 paragrafi 5.4 pika (c) të Rregulloresë së UNMIK-ut Nr. 2001/19 të datës 13.09.2001, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, U.D i Sekretarit të Përhershëm të MKRS z. Mon Zhubi, më datë 22.11.2007 merrë këtë:

### V E N D I M

1. Refuzohet vendimi i KPMP i datës 21.06.2007 nr.879/2007 me të cilin kërkohet kthimi i znj. Minire Zaka në pozitën e Menaxheres së Personelit në MKRS.
2. Rikthimi i znj.Minire Zeka në pozitën e Menaxherit të Personelit sipas rekomandimit të KPMP është i pa mundshëm për arsye se nuk ka aftësi të mjaftuara për një pozitë të tillë udhëheqëse për detyrat me të cilat ishte e ngarkuar.
3. Nga 1 Janari 2008 MKRS do të shqyrtoj mundësin e sistemimit të lartcekurës në një pozitë tjetër në përputhje me përgatitjet dhe aftësitë përfundimtare të saj.
4. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

### Arsyetim

Pas shqyrtimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës konstatohet se:

- Në bazë të vlerësimit të bërë nga Drejtori i DAQ-it për punën e kryer të znj Minire Zeka rezultoi se ka vlerësim jo pozitiv për punën e bërë gjatë vitit 2006 e në veçanti për muajin Janar 2007.
- Të njëjtës disa herë i është tërhequr vërejtja me gojë dhe me shkrim për ngritjen e cilësisë së punës dhe efikasitetit në Zyrën e Personelit, por një kërkesë të tillë ajo nuk ka mundur ta realizoi.
- Në fillim të vitit 2007, përkundër vlerësimit jopozitiv për vitin 2006, i është dhënë përsëri mundësia që të bëjë përmirësimin e punës dhe ngritjen e cilësisë dhe kualitetit në sektorin ku punon, por kjo ishte e pamundur, andaj përkundër dëshirës sonë ishimi të detyruar të ndërhyjmë në ndërrimin e gjendjes së shkaktuar e cila ishte e paqëndrueshme.
- Mos efikasiteti në punë, neglizhenca, mungesa e koordinimit me stafin e vet brenda dhe jashtë ministrisë (institucioneve të MKRS), mungesa e sistematizimit të plotë të dosjeve, mos raportimi me kohë dhe mosnjohja dhe mosrespektimi i procedurave administrative-juridike etj ishin arsyet kryesore të marrjes së një vendimi të tillë.
- Vendimi i jashtëzakonshëm i MKRS për sistemimin e znj.Zeka ka qenë në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 mbi SHCK dhe UA 2003/02 përkatësisht neni 11.1 dhe 14.2. andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

I dërgohet:  
- Palës  
- KPMP  
- Zyrës së Personelit  
- Zyrës Ligjore  
- Arkivit të Ministrisë

UNMIK  
MINISTRY OF CULTURE,  
YOUTH AND SPORTS  
PISG  
KOSOVO U.D.  
Mon Zhubi  
Sekretarit të Përhershëm



Sipas nenit 11.6 të po kësaj rregulloreje vendimi i KPMK-së konsiderohet si përfundimtar në procedurë administrative dhe duke u bazuar në Ligjin mbi Konfliktet Administrative si i tillë do të mund të apelohej vetëm Gjykatën Supreme të Kosovës e cila do të vlerësonte ligjshmërinë e vendimit.

Në esencë në këtë drejtim ka disa moskuptime sepse Gjykata Supreme pranon paditë e parashtruara nga Palët e pakënaqura për konflikt administrativ por pastaj i kthen në Gjykatat Komunale ku në shumicën e rasteve po ato gjykata më parë janë shpallur jo kompetente për të vendosur lidhur me të njëjtat lëndë. Kjo konsiderojmë se është një veprim i paarsyeshëm dhe që shkon në dëm të palëve duke krijuar vonesa të pajustificueshme .

Në anën tjetër Gjykata komunale posa ta merr padinë tashmë në cilësinë e të paditurës e fton Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës që është jashtë çdo logjike juridike sepse KPMK nuk është palë në kontest por është organ vendim marrës i autorizuar me ligj të vendos për kontestin. Paramendoni faktin sikur një gjykatë të paditej sepse vendosë një lëndë për të cilën është e thirrur me ligj dhe e ka jurisdikcionin për veprim.

Kopje e thirrjes për KPMK-në në Gjykatë dhe një vendim i Gjykatës me të cilin refuzohet padia ndaj KPMK-së që tregon absurditetin e tërë kësaj situatë.

**INTERIM ADMINISTRATION OF KOSOVO  
ADMINISTRATA E PERKOHSHME E KOSOVES  
PRIVREMENA ADMINISTRACIJA KOSOVA**

GJYKATA KOMUNALE NË Prishtinë C. nr. 420/06  
OPSTINSKI SUD U P. br.

Më \_\_\_\_\_ 200 \_\_\_\_\_  
Dana

**THIRRJE PËR SHQYRTIMIN KRYESOR - POZIV ZA GLAVNU RASPRAVU**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës nga Prishtinë  
iz ipadituri

rr. dhe nr. \_\_\_\_\_ thirret si \_\_\_\_\_  
ul. i broj \_\_\_\_\_ poziva se kao \_\_\_\_\_  
të vijë me datën 16.05.07 në ora 11<sup>00</sup> në këtë Gjykatë , dhoma nr. 38  
da se javi dana u cas. u ovaj Sud, soba br. \_\_\_\_\_

për çështjen juridike të paditësit Nora Dugagjini - Salihu të cilin  
pravnoj stvari tuzioca koga  
e përfaqëson \_\_\_\_\_  
predstavlja \_\_\_\_\_  
kundër të paditurit ju  
protiv tuzenog \_\_\_\_\_  
të cilin e përfaqëson \_\_\_\_\_  
koga predstavlja \_\_\_\_\_  
për Koua  
za \_\_\_\_\_

MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE - KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS MINISTRIJA ZA JAVNE SLUŽBE IZVAN SUDSKOGH ODBORA KOSOVA Министерство Публичних Служби и Независни Судски Одрбор Косово			
Primitur Erdhjeneg Raspisniod	26.05.2007	2007	Vendi Prishtine
Dopuni/Nendia Dopuni/Uskildia Dopuni/Urtat	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtepje Prilog Appendice	Serde Kolicina Quantity
SUPMIR	925/02		1

Gjyqtari - Sudija  
Rogip Fazel

MINISTRIA E SHERBIMEVE PUBLIKE KESHILLI I PAVARUR MBIKQYRES I KOSOVES MINISTARSTVO JAVNIH SLUZBI NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA MINISTRY OF PUBLIC SERVICES INDEPENDENT BOARD FOR KOSOVO			
Pranuar / Prilaz / Rezolvid		19.09.2007 viti / god / year	
Organizim / Organizacija / Organizat	Nr. Prir / Br. Prir / Print. No.	Titulli / Titull / Appointment	Sasia / Kolicina / Quantity
JNPM	1849		1/3

C1.nr.279/06

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA KOMUNALE NË PRISHTINË**, si gjykatë civile e shkallës së parë, në trupin gjykues në përbërje prej gjykatësës Flutra Hoxha, kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarve porot Shaban Gërgjaliu dhe Fetah Tahiri, anëtar, në qështjen juridike të paditësës Shkurte Luma nga Lipjani, Rr. Zenel Hajdini 6, të cilën e përfaqson av. Ibrahim Duriqi nga Lipjani, kundër të paditurës Keshilli I Pavarur Mbikqyres I Kosoves dhe Kuvendi Komunal-Shtime, Drejtoria per arsim dhe kulture, për pagesën e të ardhurave personale, në shqyrtimin kryesor të dt. 16.05.2007, në mungese të paditurave dhe ne prezencen e paditësës muar këtë:

## AKTGJYKIM

**MIRATOHET** si e bazuar kerkesëpadia e paditësës Shkurte Luma nga Lipjani dhe **DETYROHET** e paditura Kuvendi Komunal-Drejtoria per Arsim dhe Kulture ne Shtime „që paditësës t’ja kompenzoj pagat per punen e kryer si mesimdhënëse ne Sh.F. "Naim Frasheri", per periudhen prej 01.09.2003 deri 31.08.2004, ne shumën e pergjithshme prej 726 Euro, duke llogaritur nga 95.94 euro ne muaj, me kamate prej 3,50 % sipas tarifes se Kasa Bankes-sh.a ne Prishtine, per depozitat e afatizuara per 12 muaj qe nga dt.16.05.2007, deri ne pagesen definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimit nën kërcnim të përbarimit me dhunë.

**HUDHET** si e pa lejshme padia e paditësës e paraqitur kundër të paditësës së pare Keshilli I Pavarur Mbikqyres I Kosoves.

**DETYROHET** e paditura qe paditësës t’ia kompenzoj shpenzimet e procedures ne shumen prej 251 Euro, ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotefuqishmerise e ketij aktgjykimi nen kercnim te perbarimit me dhune.

## Arsyetim

Paditësja, nëpërmes të autorizuarit të saj, në padi dhe në shqyrtimet e mbajtura në këtë Gjykatë, ka kërkuar se Keshilli Pavarur Mbikqyres I Kosoves I krijuar prane Ministrise se Sherbimeve Publike ka leshuar vendimin lidhur me ankesen 0287/05 te dt. 25.08.2005 per qka ka vendosur qe te hudhet posht ankes per qka paditesja eshte drejtuar ne Gjykatën Supreme te Kosoves e cila me aktvendimin A.nr. 161/2006 te dt. 27.07.2006 ka hudhe poshte padine dhe ka derguar shkresat e lendes kesaj gjykate si kompetente per kete qeshtje juridike. Ka deklaruar se paditesja ka punuar ne dy vende te punes, ne shkolen e mesme ne Lipjan ku ka pasur rrogen e plote e poashtu sipas kontrates edhe ne shkollen fillore "Naim Frasheri" ne Shtime me orar jot e plote gjegjesisht I eshte paguar gjysem rroge –page dhe qe ka qene 95.94 euro. Ka punuar 12 muaj per te cilat eshte paguar vetem ne shume prej 425 euro kurse te papaguara I kan mbetur gjysem pagat ne shume prej 726 euro. Me parashtresen e dt. 29.03.2007 ka bere precizimin e padise ashtu qe ka paraqitur sit e paditur te pare Keshillin e Pavarur Mbikqyres te Kosoves dhe te paditur te dyt Kuvendit Komunal –Drejtoria per Arsim dhe Kulture ne Shtime.

Është e nevojshme të theksohet se në rastin e zbatimit të vendimeve të Këshillit sidomos në administratën lokale rol të konsiderueshme pozitiv ka luajtur edhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila pas ndryshimit të Rregullores 2001/19 ka marrë kompetenca shtesë në këtë drejtim dhe ka treguar edhe vullnet të mirë në bashkëpunim me Këshillin në ushtrimin e këtyre kompetencave.

## **FUNKCIONI I SHQYRTIMIT TË EMËRIMEVE NË NIVEL TË UDHËHEQËSVE TË DEPARTAMENTEVE NË SHCK.**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës ka një funksion specifik të cilin nuk e hasim tek organet e njëjta apo të ngjashme të shteteve për rreth e ky është monitorimi i procedurës së zgjedhjes së drejtorëve të Departamenteve në Shërbimin Civil të Kosovës pra në të gjitha Ministrinë, Agjencitë Ekzekutive dhe Komunat e Kosovës.

Ky funksion është i paraparë me nenin 12. të Rregullores 2001/36 për dhe organet punëdhënëse në SHCK janë të obliguara që të njoftojnë Këshillin për kohën e mbajtjes së intervistës për plotësimin e vendeve të punës së drejtorëve të departamentit dhe që komisionit të caktuar për vëzhgim të KPMK-së ti paraqes tërë dokumentacionin e nevojshëm lidhur me realizimin e konkursit për të cilin KPMK është ftuar.

(kopje e ftesës për monitorim)



MEM - MEM - MER	
No. 463	dt. 17-04-07
PRA	Zey MEM
REC	
PRI	
FQ	
PA	1
ST	MINISTRIA E ENERGJISË DHE MINIERAVE
PËR	MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA
TO	MINISTRY OF ENERGY AND MINING



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS

VLADA KOSOVA

GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Energjisë dhe Minierave

Ministarstvo za Energiju i Rudarstva

Ministry of Energy and Mining

MINISTRIA E ENERGJISË DHE MINIERAVE	
MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA	
MINISTRY OF ENERGY AND MINING	
KOSOVA	
17-04-2007	
1120	1120
834/07	834/07
SKPMV	SKPMV

Për : Sevdail Kastrati, Kryetar i KPMK-së

Përmes : Resmije Mumxhu, drejtor DAQ *Resmije Mumxhu*

Nga : Florina Mehaj-Kosumi, udhëheqëse e divizionit të personelit *Florina Mehaj-Kosumi*

Tema : Ftesë për pjesëmarrje në monitorim të procedurës së intervistimit

Datë: 17/04/2007

Të nderuar anëtarë të KPMK-së,

Ju ftojme të merrni pjesë në monitorim të procedurës së intervistimit për pozitën :

1. Drejtor i Prokurimit


Pozitë kjo e publikuara në gazetat "Zëri" dhe "Kosova Sot" dhe emituar në Radion multietnike Radio "K" me dt. 24.02.2007, si dhe është bërë zgjatja e afatit për konkurrim edhe për 15 ditë të tjera. Zgjatja e afatit për konkurrim është publikuar në gazetat e përditshme "Koha Ditore", "Zëri" dhe "Kosova Sot" si dhe ritransmetuar në Radion "K" në Fushë Kosovë, me datën 12.03.2007.

Intervista do të mbahet më dt. 20.04.2007 duke filluar në ora 10<sup>00</sup> në lokalet e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Qyteza Pejton Rr." Sejdi Kryeziu " Nr. 5, Prishtinë.

Ju falënderojmë për mirëkuptim .

Me respekt,

Duke ushtruar këtë funksion KPMK ka realizuar 46 vizita vëzhguese në gjatë të cilave është monitoruar procedura ligjore e zgjedhjes së 134 drejtorëve të departamenteve.(shih diagramin e mëposhtëm)



Gjatë ushtrimit të këtij funksioni Këshilli (një komision tre anëtarësh i tij) vërteton se a janë plotësuar kushtet për mbajtjen e intervistës, duke kontrolluar dosjen complete të rekrutimit për rastin konkret e sidomos kopjen e konkursit të shpallur, përbërjen e komisionit intervistues duke u kujdesur që ai ti ketë përmbushur kriteret e parapara me nenin 7.2 të UA 2003/2, listën e kandidatëve që kanë konkurruar ,mbarëvajtjen e intervistës dhe pas marrjes së raportit nga Organi punëdhënës vendos nëse kjo procedurë ka qenë në përputhje me parimet udhëheqëse të Shërbimit Civil të Kosovës.

Organet punëdhënëse zakonisht përfillin aty për aty vërejtjet e Komisionit prezent të këshillit dhe konsultohen me te për hapat e më tejme. Gjatë vitit të kaluar vetëm Komuna e Klinës nuk ka përfillur një rekomandim të KPMK-së dhe përkundër vërejtjeve nga komisioni ka mbajtur intervistën për drejtorë të departamenteve. Ky rast është raportuar tek PSSP dhe Kryeministri i Kosovës

Një komision i KPMK-së gjithashtu ka raportuar tek PSSP dhe kryeministri I Kosovës se Ministria e Drejtësisë kishte shkelur parimin e meritës (neni 2.1 i Rregullores 2001/36) me rastin e emërimit të Drejtorit të departamentit të Drejtave Civile.



## **REKOMANDIMET MË TË SHPESHTA TË KPMK-së GJATË USHTRIMIT TË KËTIJ FUNKSIONI**

Vërejtjet më të shpeshta që u bëhen autoriteteve punëdhënëse me rastin e vëzhgimit të procedurës së emërimit të drejtorëve të departamenteve e që shoqërohen edhe me rekomandime përkatëse janë:

**Mos kompensimi i komisionit intervistues sipas nenit 7.2 të UA 2003/2,**

**Mos shpallja e konkursit publik sipas nenit 4.1 të UA 2003/2 dhe**

**Mos zgjatja e afatit të konkursit sipas nenit 4.2(g) të njës UA.**

Sikur u tha edhe me lartë në shumicën absolute këto vërejtje e rekomandime përfillen dhe konkursi ri përsëritet me ç`rast lëshimet e evidentuara mënjanoen.

(shih një konkurs të vazhduar sipas sugjerimit të KPMK-së dhe një raport nga vëzhgimi i procesit të monitorimit të emërimit të drejtorëve të Departamenteve)



Data: 09.08.2007

Në pajtim me nenin 4.paragrafin 4.2 nën pikën(g), mbi shpalljet e vendeve të lira të punës sipas Urdhërësës Administrative Nr.2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës ,me qëllim të arrijtes se një ekuilibri të balancuar të kandidatëve sipas përfaqësimit etnik, Zyra e Personelit të Administratës Tatimore të Kosovës lëshion këte :

#### NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSI

Njoftohen të gjithë të interesuarit se vazhdohet afati i konkursit të shpallur në gazetën ditore "Zëri" dhe "Koha Ditore" me datë 25.07.2007 për këto pozita të punës:

1. Zëvendës Menaxher në Njësinë e Tatimpag. të Medhenjë, nr. i ref:MEF/ATK 018/07/2007
2. Udhëheqës Ekipi për Edukimin e Tatimpag. në Prishtinë I, nr. i ref:MEF/ATK 019/07/2007

Konkursi do të jetë i hapur deri me datën 23.08.2007

Përmbajtja e konkursit për këto 2 (dy) pozita mbetet e njëjtë me konkursin e shpallur me datën 25.07.2007.

Kandidatët që kanë aplikuar me heret për këto pozita nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopje të dokumenteve të kerkuara sipas konkursit dorzohen në Zyren Qendrore të Administratës Tatimore të Kosovës në Adresën : Këndi i rrugëve "Bill Clinton" dhe "Nena Tereze" p.n. në Prishtinë apo përmes postës .Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/200 250 22 apo adresës elektronike [ilir.islami@atk-ks.org](mailto:ilir.islami@atk-ks.org) Ftohen dhe inkurajohen kandidatët e etniteteve joshqiptare të Kosovës të marrin pjesë në këtë konkurs.

Datum: 09.08.2007

U skladu se članom 4, stav 4.2 tačka (g), o proglašenju slobodnih radnih mesta po Administrativnom Neredjenju Br.2003/2 o primeni Uredbe UNMIK-a br.2001/36 o Javnoj Službi na Kosovu , a u cilju uspostavljanja jednakih uslova svih kandidata po etničkoj pripadnosti, Kancelarija za Ljudske Resurse Poreske Administracije Kosova ,objavljuje sledeće :

#### O B A V E Š T E N J E O PRODUŽETKU ROKA KONKURSA

Obaveštavaju svi zainteresovani da se produžuje rok konkursa objavljen u dnevnom listu "Zëri" i "Koha ditore" od 25.07.2007,za sledeće radne pozicije:

1. Zamenik Menadžera u Jedinici Velikih Poreskih Obveznika, br.ref.018/07/2007
2. Rukovodilac Ekipe za Edukaciji Poreskih Obveznika Reg.Kan.Priština I, br.ref.019/07/2007

Konkurs biće otvoren do 23.08.2007

Sadržaj konkursa za ove dve (2) pozicije ostaje isti , kao u konkursu objavljen dana 25.07.2007.

Kandidati koji su aplicirali ranije za ove pozicije ne moraju da ponovo apliciraju.

Popunjene aplikacije sa traženim fotokopiranim dokumentima prema konkursu dostavljaju se u Centralnoj Kancelariji Poreske Administracije Kosova na adresi:Ugao puteva "Bill Clinton" i "Nena Tereze" b.b. u Prištini ili preko pošte.Za dodatne informacije obratite se na telefon 038/200 255 22 ili elektronsku adresu: [ilir.islami@atk-ks.org](mailto:ilir.islami@atk-ks.org)

Pozivaju i potičaju se kandidati nealbanskih etnieteta Kosova da učestvuju u konkursu.



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTERIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI  
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVO  
INDEPEDENT OVERSIGHT BOARD KOSOVO

DATË/A..... 15. 08. 2007

REFERENCE..... Vendimi i KPMK-së i datës 21. 07. 2007

PËR/ZA/TO:..... KPMK

NEPERMJET/PREKO/THROUGH:..... Kryesuesit të KPMK-së

NGA/OD/FROM : Komisioni i KPMK –së në përbërje: Mursel Ahmeti,  
Flora Balidemaj dhe  
Bisera Spahi

LENDË/SUBJEKAT/SUBJECT: **Raporti i Komisionit që e ka vëzhguar procesin e emrimit në nivel të Drejtorit të Departamentit.**

**Autoriteti punëdhënës: komuna Istog.**

**Posti: Drejtor i Drejtoratit për Arsim.**

Komisioni i lartpërmendur i formuar me Vendim të Këshillit të Pavarur Mbiqyrës të Kosovës, në mbledhjen e datës 21. 07. 2007, ka prezentuar në procesin intervistimit të kandidatëve që është mbajtur më 30. 07. 2007 ashtu si ishte parapar

Para fillimit të intervistimit të kandidatve, komisionit e ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin relevant për procesin e emrimit.

Komisioni e ka shiquar dokumentacionin e prezentuar;

-vendimi i Kuvendit të Komunës për shpalljen e konkursit

- shpallja e konkursit është bërë sipas procedurës së paraparë dhe është vazhduar,
- Vendimi i Kuvendit të komunës për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve i formuar sipas procedurës së paraparë dhe i balancuar,
- lista e gjërë e kandidatëve me të dhënat e nevojshme,
- zgjedhja e kandidatve për listën e ngushtë,
- trajtimi i kandidatëve me rastin e intervistimit ka qenë korrekt,
- procesin e intervistimit e ka ndihmuar Menagjeri i personelit.

Menagjeri i personelit i ka dërguar Këshillit, Vendimin e Kuvendit të komunës 01 Numër 33/07 të datës 07. 08. 2007, nga i cili shihet se Kuvendi e ka emëruar Drejtor të Drejtoratit për Arsim z. Agim Haxhiu i cili ka fituar më së shumti pikë dhe e ka rekomanduar Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve.

Komisioni unanimisht ka konstatuar se procedura e emrimit ka qenë korrekte dhe në pajtim me parimet udhëheqëse të Shërbimit Civil të parashtruara në Rregulloren mbi Shërbimin Civil të Kosovës Nr. 2001/36 neni 2 pika 2.1.

Komisioni i rekomandon Këshillit që pas shqyrtimit të Raportit të komisionit të miratoi

#### V E N D I M

Emrimi i z. Agim Haxhiu në postin Drejtor i Drejtoratit për Arsim në komunën e Istogut, është bërë në pajtim me Parimet udhëheqëse të SHCK.

Shtesë: shkresat e lëndës

K o m i s i o n i

Mursel Ahmeti

Flora Balidemaj

Bisera Spahi

Procesin e intervistimit të kandidatëve për Drejtor të kësaj Drejtorie e kanë monitoruar: - Përfaqësuesi i UNMIK-ut dhe,  
- Përfaqësuesi i OSBE-së.



Edhe pse me Rregulloren për Shërbimin Civil të Kosovës (neni 1) janë të përkufizuar si shërbyes civil drejtorët e departamenteve të Ministrive dhe Agjensioneve Ekzekutive kanë dallime në mënyrën e zgjedhjes nga drejtorët e departamenteve të Komunave të Kosovës . Të parët zgjedhën sipas procedurave të përgjithshme të parapara me LSHCK dhe UA 2003/2 ndërsa Drejtorët e Dep. të Komunave kanë një karakteristikë sepse kanë edhe një akt juridik më shumë në përdorim Rregulloren 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave dhe involvimin e Asambleve Komunale në këtë proces. (neni 31 i kësaj Rregulloreje)

Në këtë kontekst është shumë diskutabile nga aspekti i parimeve udhëheqëse të SHCK çështja formale e emërimit të drejtorëve nga an e asamblesë komunale kjo për faktin se shumica dërmuese e deputetëve në Kuvendet komunale zgjedhën sipas kriterëve të përkatësisë politike dhe në praktikë është vështirë të mënjanohet vullneti i tyre politik me rastin e votimit për kandidatin që duhet të zgjidhet në postin e departamentit.

Ndërsa edhe pse sipas funksionit nuk mund të llogariten se janë në pozitën e drejtorëve të departamenteve e zgjedhjen e tyre nuk e monitoron drejtpërsëdrejti KPMK-ja një kategori e drejtorëve është sidomos “problematike” nga aspekti i zbatimit të dispozitave ligjore duke gërshetuar në vete dy loje të normave ligjore që shpesh janë kontradiktore në mes vete. Fjala është për drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të cilët zgjidhen sipas procedurave të parapara me ligji mbi Arsimin dhe udhëzimet administrative të Ministrisë së Arsimit e të cilat shpesh nuk përmbushin kriteret e parapara me ligjin mbi Shërbimin Civil edhe pse drejtorët e Shkollave e edhe i tërë personeli arsimor në kuptimin e ligjit mbi SHCK janë shërbyes civilë. Kjo sidomos vjen në pyetje tek formimi i komisionit intervistues i cili nuk përmbushë kriteret e nenit 7,2 të UA 2003/2.

Sidoqoftë komisioni vëzhgues i KPMK-së i ka parasysh specifikat e rastit dhe gjithmonë kujdeset për ligjshmërinë e procedurës të vëzhguar.

## **FUNKSIONI I VLERËSIMIT TË RESPEKTIMIT TË LIGJIT**

Në bazë të nenit 13 të Rregullores, 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli ka kryer funksionin e vlerësimit të zbatimit të ligjit nëpër autoritetet punëdhënëse.

Një administratë efikase ,funktionale e qëndrueshme nuk mund të imagjinohet pa një bazë solide ligjore e sidomos jo nëse atë legjislacion nuk e përfillë dhe zbaton në masën e duhur.

KPMK ka pikërisht si qëllim kontrollin e nivelit të zbatimit të ligjit për Shërbimin Civil në Organet Punëdhënëse si dhe eliminimin e të metave dhe lëshimeve atje ku ato janë evidentuar pas vizitave që u janë bërë këtyre organeve.

Gjatë ushtrimit të këtij funksioni Këshilli ka aplikuar metoda të njohura ,të aplikueshme edhe në organet si KPMK-ja në Angli, Shqipëri, Rumani, Maqedoni, Kanada etj.

Vizitat monitoruese-kontrolluese janë bërë në organet punëdhënëse të Shërbimit Civil të Kosovës sipas planit paraprak të miratuar në Këshill.

Ndërsa i tërë procesi i zhvillimit të kontrollimeve bazohej në **pyetësorin unik** i cili saktësisht parashihet aktivitetet që ndërmerren, dokumentacionin që kërkohet të kontrollohet, personat që kontaktohen etj.

Për këtë qëllim janë kryer vizita monitoruese në këto autoritetet punëdhënëse:

-Presidencë.....	1 vizitë
-Ministri .....	10 vizita
-Agjenci Ekzekutive .....	3 vizita
-Kryeministri .....	1 vizitë
-Kuvend të Kosovës .....	1 vizitë
-Komuna .....	22 vizita
-ATK .....	1 vizitë
-Spitale rajonale .....	3 vizita
-Qendrën e studentëve .....	1 vizitë
-Këshill gjyqësor të Kosovës.....	1 vizitë
-Pilot Njësi Komunale.....	3 vizita

Gjatë procesit të monitorimit KPMK ka konstatuar se në krahasim me vitin paraprak është bërë përparim në zbatimin e proceduarve të parapara me Rregulloren 2001/36 por ende ka raste ku ka sfera që duhet të përmirësohen dhe për këtë Këshilli ka lëshuar 51 raporte me rekomandime për përmirësimin e veprimeve të caktuara.

**Rekomandimet kanë të bëjnë kryesisht në këto fusha:**

Mos emërimi menaxherit të personelit,

Mos bartja e kompetencave menaxherit të personelit,

Kohëzgjatja e kontratave të punës në kundërshtim me ligjin,

Moskompletimi i dosjeve personale,

Mosmbulimi i dosjeve personale të shëndetësisë dhe arsimit nga ana e autoriteteve të komunës,

Të metat në zhvillimin e procedurave të konkursit.

Fushat të cilat gjatë vizitave monitoruese janë cilësuar se duhen përmirësime karakteristike janë p.sh.: Kryeshefat ekzekutivë në disa komuna akoma nënshkruajnë kontratat e punës (p. sh. K. K. Kamenicë, Obiliq etj), duke mos e bartë këtë përgjegjësi tek menaxherët e personelit të cilët sipas ligjit janë organ i emërimit dhe natyrisht që kryeshefat ekzekutivë janë zyrtarët më të lartë ekzekutiv dhe aprovues, meqë nënshkrimi i kontratave nga menaxherët e personelit është më shumë çështje teknike se sa substanciale. Në dosjet personale ka mungesa të dokumentacionit personal në bazë të cilit do të përcaktohej mosha e shërbyesit civil dhe statusi i banorit të Kosovës (kopje e letërnjoftimit apo certifikata e lindjes) e që lidhen me pensionimin e shërbyesit civil dhe fitimin e statusit të shërbyesit civil.

Gjithashtu, ka shumë paqartësi në procesin e avancimit të shërbyesve civilë dhe në disa raste ndërmerren edhe veprime jo ligjore (Ministria e Bujqësisë).

Nga këndvështrimi i Këshillit të Pavarur, transformimi i Zyrave Ligjore në Departamente Ligjore me një udhëzim administrativ është mjaft kontestues dhe sidomos është kontestues emërimi automatik i udhëheqësve të zyrave ligjore në drejtor të departamenteve. Për shkak se gjatë emërimit të drejtorëve të departamenteve është e obligueshme pjesëmarrja e KPMK-së që në rastin konkret fare nuk ka ndodhur.

Duke u bazuar në rekomandimet e vazhdueshme të këshillit në çështjen e mbulimit të dosjeve personale të punësuarve në arsim dhe shëndetësi ku juridikisht Komuna ka statusin e punëdhënësit janë bërë përparime. Në shumicën e komunave në këto dosje tashme kanë qasje menaxheret e personelit të komunave por akoma ka komuna ku kjo nuk ka mundur të bëhet në Komunën e Kaçanikut ku i tërë procesi zhvillohej pa qasje të zyrës së personelit të komunës, gjithashtu kështu ndodh edhe në Podujevë.

Gjithashtu është vërejtur një përparim tek roli ankimeve në këto fusha sepse Në shumë raste si në Prizren, Kaçanik, Prishtinë etj edhe shërbyesit civil të arsimit dhe shëndetësisë ankesat e tyre i drejtojnë në komisionin e ankesave të Komunës.

Procedurat disiplinore udhëhiqen në mënyrë më profesionale dhe si duket rekomandimet e viteve paraprake të KPMK dhe vizitat me të shpeshta kanë ndikuar që masa disiplinore më e rëndë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të shqiptohet vetëm në raste vërtetë drastike të shkeljeve ligjore.

Gjatë vizitave KPMK ka konstatuar se ka Organe punëdhënëse ku nuk behen vlerësimet e rregullta të punës dhe ku kontratat e punës nuk vazhdojnë sipas rregullave të parapara (komuna e Prishtinës, Ministria e Kulturës)

Në disa raste si në Komunën e Gjilanit apo në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Kthimit dhe Komuniteteve me të punësuar janë lidhur kontrata mbi vepër apo kontrata mbi shërbim të veçantë të cilat Ligji për Shërbimin Civil nuk i parasheh.

KPMK ka gjetur se në disa raste konkurset nuk janë shpallur në përputhje me Kriteret e parapara me nenin 4.2 të UA 2003/2 dhe për këtë ka obliguar Organin Punëdhënës ri përsëritjen e shpalljes publike në Ministrinë e Shërbimeve Publike (rasti i konkursit për drejtor të Dep. të prokurimit)



## VLERËSIMI I JASHTZAKONSHËM I RRESPEKTIMIT TË LIGJIT SIPAS KËRKESAVE TË VEÇANTA

Duke u bazuar në dispozitën nenit 14.1 (c) Kryeministri i Kosovës në dy raste ka kërkuar me kërkesë të veçantë vlerësim të respektimit të Ligjit mbi shërbimin Civil sipas pikave të specifikuara në kërkesë dhe atë: në Komunën e Gjilanit dhe në Ministrinë për Kulturë Rini, sport e Çështje Jo Rezidente.

(shih kopjen e kërkesës së Kryeministrit të Kosovës)



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA  
VLADA  
GOVERNMENT

KRYEMINISTRI  
PREMIER  
PRIME MINISTER

21.02.07	1
540MV	37567

Sevdail Kastrati  
Kryetar i Këshillit  
të Pavarur Mbikëqyrës

Prishtinë, 20 shkurt 2007  
Protokoll: 07/ 373

I nderuari Z. Kastrati,

Po ju shkruaj në lidhje me kërkesën Nr. 07/ 1279 të datës 14 janar 2007, e cila ka ardhur nga Zyrtarët e Departamentit të Sportit-MKRSCJR. Kërkesa në fjalë ka të bëjë me konkursit e hapur me datën 9 shkurt 2007 në këtë departament.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ 2003/08 – Procedura e vlerësimit të kryerjes së punës dhe Udhëzimit Administrativ 2003/06 – Procedura e ndërprerjes së punës, kërkojmë që të bëhet një kontroll i përgjithshëm në procedurat e hapjes së konkurseve në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente.

Ju lutemi që raportin në fjalë na e dërgoni deri me 23 shkurt 2007.

Sinqerisht,

Agim Çeku  
Kryeministër i Kosovës

Pas marrjes së një kërkesë të tillë Këshilli ka autorizuar një komision të vetin i cili ka zhvilluar një kontroll në selinë e organit përkatës punëdhënës dhe pas kësaj një procesverbal me gjendjen e konstatuar dhe një raport me rekomandime ia ka dërguar kryeministrit të Kosovës.

Vlen të theksohet se në të dyja rastet pas dërgimit të raportit kryeministri i Kosovës ka mbështetur plotësisht rekomandimet e Këshillit të Pavarur dhe ka urdhëruar zbatimin e menjëhershëm të tyre,

Në Ministrinë e Kulturës çështje shumë shqetësuese ishte shpallja e konkursit për punëtorët e disa departamenteve pa u dërguar paraprakisht asnjë njoftoi për vazhdimin apo mos vazhdimin e kontratave valide të punës që kishin dhe menjëherë pas rekomandimit të KPMK-së dhe urdhëresës së Kryeministrit për zbatimin e këtyre rekomandimeve këto konkurse janë eliminuar gjë që e në rastin konkret e ka bërë realitet synimin e përmendur në hyrjen e këtij raporti të KPMK-së të titulluar "përgjigjeje efektive ndaj shqetësimeve të shërbyesve civil"

\* shih kopjen e publikuar të njoftimit për anulimin e konkurseve ne MKRSCJR)



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETEQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT  
DEPARTAMENTI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

## Anulohen konkurset

Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente ka marrë vendim sot që të anulojë konkurset e shpallura në Departamentin e Çështjeve Jorezidente më 1 shkurt 2007, atë të Departamentit të Sportit të shpallur më 9 shkurt 2007 si dhe konkurset për drejtor të Filharmonisë së Kosovës dhe për drejtor të Baletit të shpallura në mediat e shkruara më datë 3 shkurt 2007.

Lidhur me rishpalljen e konkurseve të reja publike opinioni do të njoftohet me kohë.  
Kandidatët dhe opinionin publik i falënderojmë për mirkuptim.

Departamenti për Marrëdhënie me Publikun  
**Veli Bytyqi, drejtor**

Për të mos theksuar vetëm rastet që cilësohen si negative këshilli ka kënaqësinë të veçojë edhe organe punëdhënëse me të cilat niveli i aplikimit të Ligjit për SH. Civil është plotësisht i kënaqshëm .Ku bashkëpunimi i këtyre Organeve me KPMK është mbi baza shumë parimore.

Në këtë drejtim është e rëndësishme të përmendet se puna e mirë e menaxherëve të personelit në Autoritetet punëdhënëse ka bërë zbatimin të Ligjit për Shërbimin civil ti kushtohet rëndësi e posaçme dhe që procedurat e rekrutimit, disiplinore dhe të ankimit brenda një autoriteti punëdhënës të SHCK të zhvillohen në të shumtën e rasteve në përputhje me dispozitat ligjore.

Këshilli vlerëson se menaxherët e personelit në **KK-Viti, KK-Malishevë, KK-Shtime, MTPT, Qeverinë e Kosovës, Ministrinë së shëndetësisë, Min. e Tregtisë dhe Industrisë** kanë dhënë kontribut të çmueshëm në organet e tyre punëdhënëse për aplikimin e ligjshmërisë në përgjithësi dhe të proceduarve të aplikueshme në shërbimin civil në veçanti.

Gjithashtu më të njëjtën kohë edhe Avokatët Publik të Komunave të Prishtinës, Skenderajt, Vushtrrisë dhe Ferizajt kanë treguar profesionalizëm të theksuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe bashkëpunim korrekt me këshillin.

Pavarësisht nga fakti se ndikimi i tyre në rrjedhat e përgjithshme në organin e tyre punëdhënës nuk ka qenë i plotë për shkaqe të natyrave të ndryshme.

Që Këshilli ta kryejë plotësisht me sukses këtë funksion përpos aktivitetit të tij të përditshëm dhe shumë angazhues nevojitet edhe koordinimi me organet e tjera dhe sidomos është absolutisht e rëndësishme puna e suksesshme e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil të MSHP nga e cila varen shumë trendë në Shërbimin Civil të Kosovës.

Në këtë drejtim janë vërejtur lëvizje pozitive në kohët e fundit.

## AKTIVITETE TJERA TË KËSHILLIT

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës gjatë vitit 2007 përpos detyrave të cilat i ka të parapara me ligj ka zhvilluar edhe aktivitetete tjera të cilat ishin në funksion të synimit të tretë të cekur në hyrjen e këtij raporti ”të ngritjes së kapaciteteve të brendshme të këshillit me qëllim të shtimit të efikasitetit të punës”

Për këtë qëllim është propozuar që nga kapacitetet e brendshme të këshillit të ngritët në pozitë një nëpunëse e sekretariatit në pozitën e zyrtares për Monitorim duke vlerësuar se njëjta ka njohuri të mjaftueshme për të zotëruar postin për të cilin është rekomanduar.

Gjithashtu janë organizuar seanca profesionale të punës, dhe pjesëmarrje në tryeza pune dhe seminare brenda vendit me temë për Administratën Publike si dhe vizita studimore të punës jashtë Kosovës edhe pse këto të fundit në raste shumë të pakta shkak i mungesës së mjeteve materiale në buxhetin e Këshillit .

Përvojat e fituara ishin shumë domethënëse dhe shumë të dobishme dhe një pjesë e tyre u aplikua drejtpërsëdrejti në punën e përditshme të KPMK-së që rezultoi me ngritjen e nivelit të profesionalizmit në punën e Këshillit.

Këtë kontekst KPMK mbanë relacione të shkëlqyeshme pune me Komisionin për Shërbimin Civil të Shqipërisë me të cilin shkëmben përvoja dhe bënë vizita të ndërsjella mbi bazën e një bashkëpunimi miqësor dhe parimor e profesional.

## KONFERENCAT,TRYEZAT E PUNËS DHE SEMINARET NË KOSOVË

Z. Nebojsa Azdejković anëtar i KPMK-së ka qenë për një kohë anëtar i Grupit të ekspertëve për Reformën e Administratës Publike duke marrë pjesë aktivisht në të gjitha tubimet e këtij grupi dhe ka dhënë kontributin e tij sidomos në përkufizimin e rolit të KPMK-së në këtë proces të rëndësishëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës ka marrë pjesë me një përfaqësues të vetin sa herë që i është kërkuar në mbledhjet e përmbushjes së standardit të parë (Institucionet demokratike-zbatimi i i ligjit) dhe me raporte konkrete ka dhënë kontributin e vet.

Gjithashtu në disa raste ka marrë pjesë edhe në takimet për përmbushjen e standardit III-IV, ”Liria e lëvizjes” dhe “Kthimet e qëndrueshme”.

Në tryezën”Reforma e Administratës Publike në Kosovë-Përfshirja dhe Roli i gruas mbajtur në Prishtinë me 23.10.2007 Këshilli kishte paraqitur një raport për numrin e ankesave të arritura sipas gjinisë dhe aktivitetin e Këshillit lidhur me promovimin e plotë të barazisë gjinore.

(Pamje nga konferenca me një pjesë të raportit)

**TË DREJTAT E BARABARTA GJINORE NË SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
(ANKESAT DHE REKOMANDIMET NË KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS TË KOSOVËS)**



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është organ i themeluar me Rregulloren 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës. Sipas dispozitave të këtij ligji, KPMK është organ që ka tri funksione kyçe :funksionin e zgjedhjes së ankesave,të

monitorimit të zgjedhjes së drejtorëve të Departamenteve dhe të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit të Shërbimit Civil

Objektivin ligjor të barazisë gjinore, KPMK aktivisht e promovon gjatë ushtrimit të tri funksioneve të tij, dhe sidomos gjatë zgjedhjes së ankesave të shërbyesve civilë dhe aplikuesëve për punë në Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshillit i paraqiten ankesa nga të dy gjinitë si dhe nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë .Për të ilustruar këtë, paraqesim tabelat përkatëse për vitin 2006 dhe 2007, me theks të veçantë në raportin e ankesave të paraqitura nga meshkujt dhe femrat.

Në vitin 2006 janë paraqitur 189 ankesa sipas radhitjes pasuese:

Numri i ankesave	189	
meshkuj 155	82%	
femra	31	16,4 %
Personat juridik	3	1.6%

Gjithashtu në Prishtinë Këshilli me dy përfaqësues të tijë ka marrë pjesë në konferencën një ditore” Mundësitë e Barabarta-Personat me Aftësi të Kufizuara” ku me një prezantim të përfaqësuesve të tij ka dhënë kontributin për këtë konferencë.



Inspektorati Policor i Kosovës ka ftuar përfaqësuesin e KPMK-së që të mbaj një ligjëratë me temën - " KPMK dhe Shërbimi Civil i Kosovës" për gjeneratën vijuese të Inspektorëve Policorë e cila është vlerësuar si shumë e suksesshme dhe për këtë këshilli ka marrë një falënderim të posaçëm nga Ministri i Punëve të Brendshme.

## KONFERENCAT, TRYEZAT DHE SEMINARET JASHTË KOSOVËS

Edhe pse i pa konsultuar gjatë hartimit të draftit të parë të "Ligjit Për Shërbimin Civil bile as në pjesën që ka të bëjë me pozitën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës e cila duhej të përcaktohej pas pranimit të kopjes së draftit tashmë të përgatitur. Prandaj, Këshilli në formë të shkruar ka dërguar vërejtjet e veta, ndërsa në Debatin e parë publik të organizuar për këtë ligj në Shqipëri me 24.4.2007 përmes përfaqësuesit të vet ka dhënë një mori vërejtjesh në këtë draft dhe ka shprehur pozicionin e KPMK-së lidhur me këtë draft-ligj.

Në mars të vitit 2007 Këshilli ka organizuar një seancë profesionale për marrjen e qëndrimeve lidhur me numrin e madh të ankesave, që kishin për bazë shkelputjen apo mos vazhdimin e kontratave të punës së shërbyesve civilë, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore . Kjo seancë është realizuar në Strugë të Maqedonisë me qëllim të largimit nga presioni i përditshëm dhe i vazhdueshëm i palëve. Mirëpo, Këshilli pas punës tre ditore mori vendime për më shumë se 100 lëndë.

(pamje nga tryeza e punës në Strugë)



Gjatë kthimit nga Struga anëtarët e Këshillit vizituan Agjencinë për Nëpunës Shtetëror të Maqedonisë në Shkup dhe me ç rast janë shkëmbyer pikëpamje të ndërsjella profesionale, për metodat e punës që shfrytëzohen gjatë punës së të dy organeve të ngjashme. Nikoqirët nga Shkupi i ofruan Këshillit nga Kosova hapësirat e tyre të punës në Manastir pa asnjë lloj pagese sa herë që Këshilli të ketë nevojë.

Edhe në dy tryeza të tjera pune të organizuara nga MSHP në Ohër të Maqedonisë lidhur me reformën e Administratës Publike e sidomos “Rishikimin Funkcional” KPMK, ka paraqitur qëndrimet e veta lidhur me këtë sferë të reformës duke ofruar edhe angazhimin e drejtpërdrejt të anëtarëve të vet në këtë proces.


Në muajin gusht të vitit 2007 kryetari i KPMK-së në cilësi të përfaqësuesit të Këshillit ishte ftuar të jetë pjesë e delegacionit të MSHP në Gjermani dhe para organeve kompetente të Landit të Baden Wytenbergut ka shpalosur të arriturat e Shërbimit Civil të Kosovës dhe ka shpjeguar rolin e Këshillit në mbikëqyrjen e Administratës Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës kishte marrë një ftesë nga “Agjencia Nacionale e Shërbimit civil” të Rumanisë që të marrë pjesë në konferencën Ndërkombëtare që është mbajtur në Bukuresht me temë: ”Sistemi Evropian i Pagave në Shërbimin Civil “ por për mungesë të mjeteve materiale nuk ka mundur të marrë pjesë në këtë konferencë edhe pse tematika e saj ka qenë shumë e rëndësishme për KPMK.

Ajo që nuk pati mundësi të realizohet me ftesën e parë është realizuar me rastin e ftesës së dytë nga ky agjencia dhe e sponsoruar nga DFID, që një delegacion dy anëtarësh i Këshillit ishte pjesëmarrës në Konferencën dy ditore ndërkombëtare në Bukuresht të Rumanisë të mbajtur më 29 dhe 30 Maj 2007, me temë: ”Integriteti Publik dhe Antikorupsioni në Shërbimin Civil”.

Vlen të theksohet se përfaqësuesit nga Kosova ishin të vetmit nga Ballkani. Me këtë rast pos pjesëmarrjes aktive në Konferencë janë vënë kontakte të dobishme me përfaqësues të SIGM-as, AER-it, OECD, - es etj.

(ftesa e dërguar nga Agjencia Nacionale e Shërbyesve civilë nga Rumania)



**SIGMA**

**Support for Improvement in Governance and Management**  
A joint initiative of the OECD and the European Union, principally financed by the EU

**Agentia Nationala  
a Functionarilor Publici**

*To: Independent Oversight, Kosovo*

*Mr. Sevdail Kastrati – Chairperson, Provisional Institutions of Self Government*

INVITATION



The **National Agency of Civil Servants** and **SIGMA-OECD** have the honor to invite you to take part in Bucharest on **May 29-30, 2007, 10,00 am**, to the **international conference** with the topic **“Public Integrity and Anticorruption in the Public Service”**, in order to present some of the problems encountered by other European Member States in assuring an ethic conduct within their own civil service systems, as well in implementing preventive anticorruption measures.

The international conference hosted by the National Agency of Civil Servants aims to contribute to the debate on building a sound national integrity system endowed with mechanisms able to reduce corruption in the public administration and to offer the opportunity for the participants to discuss on the legal and managerial instruments better suited for a sound pro-public integrity institution building effort.

Moreover, the goal of this conference is to facilitate the exchange of information on experiences from other EU Member States in promoting integrity in their public administrations.

The conference will be hosted by Mr. Jozsef Birtalan - President of the National Agency of Civil Servants, experts from other EU Member States, as United Kingdom, Spain, Hungary, Finland, Netherlands, France, Latvia, Lithuania, Belgium and Germany and also experts from OECD-SIGMA.

Please confirm your participation before May 15<sup>th</sup>, 2007, at tel. /fax +4021 3152686 or at the e-mail address [monica.dimitriu@anfp-map.ro](mailto:monica.dimitriu@anfp-map.ro) .

We are at your disposal in case you need more information and please receive our highest consideration,

Sincerely yours,

**Jozsef Birtalan**  
President



Ministry of Interior and Administrative Reform  
National Agency of Civil Servants  
Bucharest, sector 3  
Tel. +40 213150545  
Fax. +40 213153132

Str. Smârdan nr. 3, sector 3, București

[www.anfp-map.ro](http://www.anfp-map.ro), tel: 3150484 , fax: 3153747

Vizita me e veçantë studimore që e ka bërë KPMK-ja ishte udhëtimi në KANADA tërësisht i sponsoruar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe i organizuar me pritje në nivel shumë të lartë nga institucionet Kanadeze.



WUSC \* EUMC

1404 Scott, Ottawa, ON  
Canada K1Y 4M8

613.798.7477  
1.800.267.8699  
Fax/Télééc : 613.798.0990  
wusc@wusc.ca  
eumc@eumc.ca

[www.wusc.ca](http://www.wusc.ca)  
[www.eumc.ca](http://www.eumc.ca)

Charitable Registration Number  
Numéro d'enregistrement  
d'organisme de bienfaisance  
11930 4848 RR0001

100% post-consumer  
recycled paper, 100 % fibres  
de post-consommation.

September 10, 2007

Mr Sevdail Kastrati  
Chair  
Independent Oversight Board of Kosovo  
Pristina  
Kosovo

Dear Sir:

**Re: Invitation to visit Ottawa**

It gives me great pleasure to invite you and your colleagues on the Board and accompanying staff (as listed below) to Ottawa from November 4-10 2008 to undertake a capacity building/study tour of various government agencies, as well as WUSC's head office.

WUSC seconds Canadian advisors on behalf of the Canadian International Development Agency, CIDA's Balkans Civilian Deployment Project to work with partner agencies in Kosovo and the region on good governance and capacity building programs. As you are aware, WUSC recruited a Canadian as senior advisor to the Independent Oversight Board of Kosovo (IOB). The purpose of Anita Vandenbeld's assignment is to assist the IOB in encouraging the use of the merit principle in civil servant appointments and to facilitate the transfer of the IOB to a fully independent institution reporting to Parliament. This study tour has been organized with her assistance and is funded by the Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE).

We understand that the IOB was established in September 2004 with three main functions: to monitor compliance with the civil service law; review senior level appointments, and hear appeals that arise. We think that the study tour will provide you and your colleagues with an opportunity to observe the work of the Public Service Commission, the Public Service Labour Relations Board, and various committees within the Parliament of Canada. We will also be able to share with you our experience, as a non-governmental agency, in working collaboratively and successfully with our government.

Education  
Changes the World

L'éducation,  
ça change le monde



(Ftesa nga Kanadaja me detajet e organeve që do të vizitohen)



Members of the IOB, besides yourself, who we invite to join the study tour are:

Mursel Ahmeti  
Bajram Zogiani  
Bisera Spahi  
Nebojsa Azdejkovic  
Flore Balidemaj

We also invite the following OSCE staff members:

Lumni Rama  
Petrit Hysaj

We look forward to meeting all of you in November.

Yours sincerely,

Ravi Gupta  
Associate Executive Director  
WUSC

cc Anita Vandenbeld, Deputy Coordinator, Central Assembly Unit  
Marianne Wightman, Senior Project Manager, WUSC



(anëtarët e KPMK-së në parlamentin kanadez)



Për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës janë organizuar seminare e tryeza pune nga Komisioni i Shërbimit Civil të Kanadasë, nga Tribunali i Marrëdhënieve të Punës i nëpunësve civilë të Kanadasë, nga Zyra e Auditorit Gjeneral kanadez, nga WUSC dhe organizata të tjera joqeveritare dhe në fund edhe një pritje e nivelit shumë të lartë në senatin e Kanadasë ku senatori z. Yoine Goldstein gjatë takimit me anëtarët e Këshillit foli me fjalë miradije për popullin e Kosovës dhe mbështeti aspiratat e tij të përgjithshme duke na dëshiruar qëndrim të këndshëm në Kanadë.

(Këshilli me senatorin z. Yoine Goldstein)



Ishin gjithashtu shumë të rëndësishme tryezat e punës me Komisionin e Shërbimit Civil dhe Bordin e Marrëdhënieve të punës në Shërbimin Civil Kanadez ku Këshilli praktikisht njoftuar për metodat e punës që përdoren nga këto borde si dhe mori pjesë në një seancë dëgjimore ku u përfitua një përvojë shumë interesante gjatë zgjidhjes së lëndëve kontestuese nëpërmes ndërmjetësimit të bordit (meditation) i cili u tregua shumë efikas.

Në realizimin dhe organizimin e kësaj vizite rol të veçantë ka pasur znj. Anita Vandenbeld të cilën Këshilli e falënderon sinqerisht.

## **RAPORTI ME ORGANIZATA VENDORE E NDËRKOMBËTARE**

### **• KRYEMINISTRI KOSOVËS**

Me kryeministrin e Kosovës KPMK përpos faktit që ka dhënë pëlqimin për vazhdimin e kontratave të punës për katër anëtarë të këshillit. Gjithashtu një raport korrekt është mbajtur edhe me rastin e dy kërkesave për kontrollim të jashtëzakonshëm të dy organeve punëdhënëse në Shërbimin Civil të Kosovës, ku pas raporteve të marra nga Këshilli, që Kryeministri ka urdhëruar zbatimin e menjëhershëm të rekomandimeve të KPMK-së.

Kryeministri i Kosovës në muajin shtator 2007 ka pranuar në një takim pune të gjithë anëtarët e Këshillit me ç`rast janë diskutuar tri çështje të rëndësishme për këshillin dhe atë:

- Buxheti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,
- Pagat e anëtarëve të KPMK dhe
- Procesi i transformimit të Këshillit.

Kryeministri u informua për buxhetin shumë të kufizuar të KPMK-së si pasojë e të cilit disa aktivitete të rëndësishme janë anuluar dhe për disa të tjera është dashur të intervenoje vet zyra e tij për ndihme e disa janë mbuluar me sponsorime të organizatave të huaja. Gjithashtu u diskutua fakti se përkundër asaj që KPMK ka trefish më shumë punë se shumica e bordeve tjera të pavarura dhe se ka shumë aktivitete terreni për dallim të terave borde që kryesisht punojnë në selinë e tyre, prapë pagat e anëtarëve të Këshillit janë dyfish më të vogla.

Ndërsa për procesin e transferimit të KPMK-së u diskutua për vonesat e paarsyeshme në proces. Këshilli mori mbështetje të plotë për këto tri çështje që me besim dhe shpresë se këto synime do të realizohen në vitin 2008.

Zyra e Kryeministrit nëpërmes zyrës së sekretarit të përhershëm gjithashtu ka ndihmuar financiarisht Këshillin dhe ka ndihmuar në marrjen e vizave zyrtare për udhëtime jashtë vendit në seminare pune.

### **• MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Ministra e Shërbimeve Publike dhe gjat vitit 2007 ka mbështetur Këshillin me pajisje logjistike, derivate, material shpenzues etj., duke mundësuar funksionimin normal të Këshillit dhe duke mos pasur influencë në anën vendimmarrëse të Këshillit.

### **• MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL**

Këshilli gjatë vitit 2007 ka zhvilluar një bashkëpunim të mirë edhe me MALP dhe sidomos pas ndryshimeve të fundit të Rreg. 2001/19 ku ka marr kompetenca shtesë në rrafshin e pushtetit lokal dhe sidomos edhe në raport me KPMK- në ,ku në tri raste ka raportuar këshillin për vendime jo ligjore të organeve punëdhënëse të pushtetit lokal duke i dërguar bashkë me rastin Këshillit edhe dokumentacionin relevant të domosdoshëm për zgjedhjen e tij Kjo Ministri ka nxjerr edhe disa Udhëzime Administrative dhe Këshilla Ligjore për Pushtetin lokal të cilat KPMK i ka shfrytëzua si Akte juridike valide gjatë punës së tij.

- **OMBDUSPERSONI DHE INSTITUCIONET E TJERA TË PAVARURA**

Prej të gjitha institucioneve të pavarura, KPMK ka një raport të veçantë me Zyrën e Ombduspersonit në Kosovë i cili konsiston në një relacion shumë efikas në shkëmbimin e shënimeve lidhur me rastet e natyrës së njëjtë dhe me ofrim të dokumentacionit i cili mund të jetë relevante për zgjidhjen e suksesshme të këtyre lëndëve.

U.D i Ombduspersonit në disa raste ka vizituar KPMK-në dhe kemi shpresë që ky bashkëpunim i frytshëm të vazhdojë edhe në vitet vijuese.

Këshilli për herë të është ftuar në një tryezë të përbashkët me Institucionet e Pavarura të Kosovës në muajin dhjetor 2007 të mbajtur në selinë e Komisionit të Pavarur për Media dhe duke marrë aktivisht në këtë takim ka shprehë gatishmërinë të bashkëpunojë me të gjitha institucionet e pavarura .

- **PËRFAQSUESI SPECIAL I SEKRETARIT TË PËRGJITHËSHËM**

Mbështetur ne nenin 8.1 të Rreg. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës PSSP ka leshur 4 fletë emërimë për anëtarët e KPMK-së të cilëve ju kishte skaduar afati i fletë emërimëve të para.

Gjithashtu, PSSP gjithmonë është përgjigjur në informacionet që i janë dërguar nga ana e KPMK-së për moszbatimin e vendimeve të tij apo rekomandimeve përkatëse.

Në Maj të vitit 2007 z. Rycker ka pritur anëtarët e këshillit në zyrën e tij dhe duke i falënderuar për punën e suksesshme dhe duke i ofruar mbështetje të vazhdueshme edhe në të ardhmen.

(anëtarët e Këshillit me kryeadministratorin z. Rycker)



#### ❖ OSBE

Misioni i OSBE-së në Kosovë edhe gjatë vitit 2007 ka vazhduar ta mbështesë Këshillin në forma të ndryshme.

Nga OSBE është caktuar një bashkëpunëtor profesional për ndihmë organeve të pavarura në Kosovë dhe atë znj. Vandelbeld e cila një kohë të mirë të punës së saj ia ka kushtuar pikërisht KPMK.

OSBE gjithashtu ka sponsoruar një emision televiziv në TV 21 në më 24 tetor në temë Shërbimi Civil në Kosovë në të cilin pos pjesëmarrësve tjerë është ftuar dhe ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i Këshillit për të paraqitur punën e KPMK-së si organ mbikëqyrës e vendimmarrës për SHCK.

OSBE ka ndihmuar në grupin punës për transformimin e Këshillit me një përfaqësues të vetin dhe së fundi OSBE ka sponsoruar dhe ka organizuar udhëtimin në Kanada për KPMK-në.



## ● VËSHIRËSITË DHE PENGESAT NË PUNË

a) procesi i papërfunduar i transformimit të KPMK-së në një organ të pavarur që do të raportojë Kuvendit të Kosovës në përputhje me nenin 7.2 (pasusi i fundit) i Rregullores 2001/36.

Me ligjin për Shërbimin Civil Këshilli është paraparë të jetë “njësi autonome brenda Ministrisë së Shërbimeve Publike, ndërsa në tekstin e Ligjit në Gjuhën Angleze precizohet se është njësi autonome me Lokacion në MSHP, pas kalimit ë afatit prej dy vitesh pozita e këshillit do të shqyrtohet me qëllim të transferimit të tij në një organ tërësisht të pavarur që do të raportojë vetëm Kuvendit të Kosovës. Ky proces i filluar në shkurt të vitit 2007 nuk ka përfunduar për shkaqet e ndryshme, pra KPMK ende ndodhet në pozitë të njëjtë të statusit juridik.

Edhe pse i pavarur ne vendimmarrje,realisht përkatësia e këshillit qofte edhe simbolike brenda një Ministrie krijon pengesa në punën e tij kjo nga shkakut se paanësia e tij vihej herë në pyetje nga organe punëdhënëse në Shërbimin Civil e sidomos nga disa prej Ministrive duke apostrofuar fatin se “**si mund të kontrollohej një Ministri nga një organ i një ministrie tjetër**” dhe i cili nuk është mbi Ministrinë.

Është absolutisht e nevojshme që ky proces të përfundojë sa më shpejt që është E mundur në mënyrë që të sigurohet edhe “pavarësia formale e Këshillit”.

**b) mungesa konstante e një anëtari të këshillit në përbërjen e tij**

Gati tërë vitin 2007 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka funksionuar me gjashtë Anëtarë të tij edhe pse me ligj janë të paraparë 7 (shtatë). Kur merret parasysh se gjatë këtij viti kemi pasur një numër të shtuar të ankesave dhe duke e marrë parasysh faktin se KPMK është organ kolektiv në të cilin të gjitha detyrat e punës kryhen në përbërje

komisionesh prej tre anëtarësh atëherë është e qartë se sa është e domosdoshme që anëtari i shtatë i KPMK-së të emërohet sa më shpejt që është e mundur.

**c) Buxheti i pamjaftueshëm i Këshillit**

Buxheti i Këshillit në përpos pagave të siguruar nuk siguron mundësi të tjera për funksionim të lirshëm të aktiviteteve tjera sikur janë vizitat studimore, blerja e literaturës profesionale e të domosdoshme për aftësim profesional,ndjekja e trajnimeve të nevojshme etj.

Këshilli në dy vitet e kaluar ka paraqitur kërkesat e veta buxhetore në përputhje me nevojat reale por në asnjë rast ai buxhet nuk është realizuar,përkundrazi

Nga Ministria e Financave asnjëherë nuk është ftuar në seancat dëgjimore të buxhetit ku do të mbronte kërkesat e tij.

**d) numri i madh i lëndëve të ankesave që kufizon mundësitë e marrjes efikase me dy aktivitete tjera të Këshillit**

Si pasojë e shkurtimeve buxhetore në Këshill kanë arritur dy herë e më shumë ankesa se në vitin 2006, ndërsa kapacitetet njerëzore të Këshillit kanë mbetur të njëjtat, bile edhe më të zvogëluara për një anëtar. Kjo situatë ka detyruar anëtarët e Këshillit të përkushtohen më shumë në zgjidhjen e lëndëve dhe për pasojë ka pasur më pak kohë për ushtrimin e dy aktiviteteve tjera të Këshillit edhe pse për to është bërë përkushtim maksimal.

Në këtë kontekst një pengesë fizike ka qenë edhe mungesa e një salle për mbajtjen e seancave sepse në mungesë të sajë komisionet e Këshillit kanë shfrytëzuar me ndërrime të vetmen sallë ekzistuese, që ka shkaktuar vonesa të pa arsyeshme të cilat me siguri do të evitoheshin sikur Këshilli të kishte edhe një sallë për mbajtjen e seancave dëgjimore.

## SFIDAT E TË ARDHMES

Në vitin 2008 këshilli pritet të përballet me angazhime të shtuara pune dhe me aktivitete disa prej të cilave lirisht mund të cilësohen si sfida të vërteta.

### **1. Adaptimi i Këshillit në kushtet e reja të punës si organ i pavarur që raporton në Kuvend**

Nën supozimin e bazuar se KPMK në vitin 2008 do të jetë një Organ tashmë i transformuar i pavarur që do të raportojë Kuvendit të Kosovës, është sfiduese situata në të cilën anëtarët e këshillit do të duhet të adaptohen në kushte të reja pune duke ditur se cili do të jetë roli i tyre i ri dhe cila do të jetë vija e përgjegjësisë së tyre.

Në po të njëjtën kohë Këshilli duhet të përgatisë rregullat e reja të organizimit të brendshëm dhe Rregulloren për procedurat e ankimit në KPMK të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi i Kosovës.

Në kushte të reja Këshilli duhet të propozojë të shpresojmë një buxhet të mjaftueshëm për të i cili tërësisht do të menaxhohet nga ai dhe për realizimin e suksesshëm të tij duhet vetë të mbajë përgjegjësi.

### **2. Realizimi i plotë i mbikëqyrjes të SHC të Kosovës**

Shërbimi Civil i Kosovës më nuk është në fazën e themelimit e as të konsolidimit, andaj Këshilli do të kërkojë në secilën situatë zbatimin e plotë të normave ligjore e sidomos me rastin e kompozimit të komisioneve intervistuese për pozita në SHCK dhe tek procedurat disiplinore e të komisioneve të ankesave në Autoritete Punëdhënëse.

### **3. Përballja me numrin e shtuar të ankesave në KPMK**

Me kushtet e shkurtimit FMN për uljen e numrit të punësuarve në SHCK të përmbushjen me përpikëri, në Këshill edhe gjatë vitit 2008 pritet numër i shtuar ankesave të shërbyesve civilë.

Gjithashtu numrit të rritur të ankesave në KPMK me siguri do të kontribuojë edhe situata e krijuar me pjesëmarrjen e shërbyesve civilë në zgjedhje si pasojë e të cilës shkaku i mos përmbajtjes së normave ligjore një numër i shërbyesve civilë për një kohe kanë mbetur pa të ardhura personale e një numër i tyre edhe pa vend pune.

### **4. Përgjigja efikase në të gjitha kërkesat për monitorim**

Si pasojë e ndryshimeve të rregullores 2000/45 në “Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës” me Rregulloren 2007/30 edhe statusi juridik i kategorisë së drejtorëve të drejtorive komunale ka ndryshuar rrënjësisht.

Në këtë drejtim gjatë vitit 2008 priten ftesat për vëzhgimin e procesit të emërimit të drejtorëve të personelit dhe administratës nga të gjitha Komunat e Kosovës e edhe të emërimit të drejtorëve të departamenteve në Ministrinë e Kosovës dhe Agjencitë ekzekutive.

Duke ditur se në këtë proces këshilli sipas ligjit duhet domosdo të jetë i involvuar me një komision prej tre anëtarësh e duke qenë plotësisht e mundur që të njëjtën ditë të ketë dy procese emërimi drejtorësh në dy Organe të ndryshme punësimi në Shërbimin civil dhe duke mos harruar faktin se Këshilli ka vetëm gjashtë anëtarë. Përgjigja efektive ndaj të gjitha kërkesave vërtetë mund të paraqesë sfidë për KPMK-në.

Raporti vjetor i Këshillit për vitin 2007 nuk kishte synim të paraqesë të gjithë punën E këshillit gjatë vitit raportues sepse këtë edhe po të donte nuk do arrinte ta bënte shkaku i shumë aktiviteteve të zhvilluara. Por besojmë se kemi arritur të shkoqisim pikat kryesore me të cilat Këshilli identifikohet.

Të gjithë atyre të cilëve ky raport i punës u dedikohet janë të mirëseardhur të japin komentet, sugjerimet dhe kritikën eventuale. Secili koment e kritikë që do të arrijë do të jetë i vlefshëm për këshillin dhe do të analizohet me përkushtimin maksimal të anëtarëve të tij. me qëllim të përmirësimit të punës në të ardhmen dhe eliminimit të lëshimeve të apostrofuara në koment apo kritikë.

Secili Organ i Punësimi në Shërbimin Civil të Kosovës i cili ka pasur relacione të dejtë për drejta pune me Këshillin është i mirëseardhur të dërgojë komente e veta lidhur me sjelljen profesionale të anëtarëve të këshillit dhe për punën e këshillit në përgjithësi. Të gjitha komentet do të shqyrtohen në mënyrë shumë serioze dhe në përputhje me rezultatet e shqyrtimit do të nxirren konkluzione përkatëse.

KPMK me këtë rast falënderon të gjitha organet vendore e ndërkombëtare dhe individët. për mbështetjen që i kanë dhënë Këshillit në punën e tij. Falënderim i veçantë u dërgohet mediave të shkruara dhe elektronike për raportim korrekt për punën e Këshillit.